



KUVENDI

Revistë e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 43-44 Shkurt 2014

“Ne kemi nevojë të mësojmë nga shembujt e mirë, por edhe të këqij të të tjerëve, kemi nevojë të mësojmë të kaluarën për të mos na u përsëritur historia, as si farsë, as si tragjedi, kemi nevojë të mbajmë gjallë amanetin e themeluesve të pavarësisë së Kosovës, për lirinë, për nderin dhe begatinë e vendit e popullit që përfaqësojmë”.

dr. Jakup Krasniqi



17 shkurt 2008 - 2014

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

PËRMBAJTJA

LEGJISLATURA IV 2010 - 2014 Aktiviteti Parlamentar, Puna E Komisioneve, Degjime Publike, Seanca Plenare	4
PËRVJETORI I SHPALLJES SË PAVARËSISË	32
KOSOVA! - PA U NDALUR DREJT ZHVILLIMIT	39
DEKLARIMET E KRYETARËVE TË GRUPEVE PARLAMENTARE	44
DIPLOMACIA PARLAMENTARE	46
GRUPI I GRAVE DEPUTETE	50
INFORMACION VËSHTRIM HISTORIK MBI TERRORIZMIN DHE AKTET TERRORISTE	52
PYETJE PA PERGJIGJE	60
ART, SPORT, KULTURË	64

E boton: Zyra për marrëdhënie me publikun dhe media

Sesioni pranveror i punimeve të Kuvendit “ I Vështirë ”

Kuvendi i Kosovës fillon sesionin pranveror, sesioni i fundit i kësaj legjislature, (Legjislatura IV). Ky sesion merr vlera të një rëndësie të veçantë, duke u kthyer në një nga sesionet më të vështira të jetës parlamentare të Kosovës, pasi do të ketë një nga agjendat më të ngjeshura. Ky sesion, përveç agjendës së zakonshme të kohës së vet, do të ketë edhe problemet e reja, si edhe ato të pazgjidhura në pas kohë.

- Ky sesion ka përpara një nga problemet themelore, atë të zgjedhjeve të përgjithshme. Zgjedhjet lokale, të cilat përfunduan në fund vitin 2013, u zhvilluan me një frymë të re, që përgjithësisht u konsideruan të qeta, pa probleme dhe të pranuar si zgjedhjet më të mira për një shtet të ri si Kosova. E megjithatë reforma zgjedhore, e vendosur edhe si kusht nga BE përbën një nga problemet themelore të këtij sesioni. Ndryshimi i Kodit Zgjedhor si dhe ndryshimet Kushtetuese të parashikuara më parë do të shtojë pikëpyetjet, për kohën e zhvillimit të zgjedhjeve të përgjithshme, të cilat me siguri do të ndikojë drejtpërdrejtë në agjendën e punës së Kuvendit gjatë këtij sesioni.

- Mos përmbyllja e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, e cila është edhe një nga problemet më të theksuara të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës, do të kërkojë kohën e vet për miratimin e ligjeve të pa miratuara të vendosura

si plotësim i kushteve të BE-së. Normalisht realizimi i tyre do të kërkojë kohë dhe punë konkretet serioze, e cila do të ngjeshë agjendën e këtij sesioni.

- Zhvillimi ekonomik i Kosovës për shkak të problematikave të ndryshme, kërkesa për rishikimin në tërësi e problemit të privatizimit në fund vitin 2013, do të hapë probleme buxhetore dhe zhvillimore për ekonominë e Kosovës. Ngecja e privatizimit të PTK-së i shtruar për zgjidhje gjatë gjithë vitit të kaluar dhe të tjera, përveç problemeve buxhetore dhe ekonomike, mund të hapë edhe probleme në ecurinë e investimeve të huaja, për një kohë të gjatë, aq të domosdoshme për Kosovën.

Ecuria e mëtejshme e bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë, integrimi i veriut në procesin e zgjedhjeve të përgjithshme, si dhe implementimi i marrëveshjeve të përfunduara midis dy vendeve, sigurisht ka dhe do të ketë koston e vet në problematikën politike, e cila do të shtojë impenjime të tjera të punës së Kuvendit.

Zhvillimi i reformave në tërësinë e vet, i cili mund të mbetet prapa, si dhe zhvillimet e reja në evoluim të skenës politike të Kosovës, plus problemet e tjera të punës së Kuvendit do të bëjnë me siguri që zhvillimi i punimeve të këtij sesioni të jetë shumë i vështirë.

KOMISIONET E PËRHERSHME

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Sesionin pranveror të këtij viti, Komisioni ka filluar punën me shqyrtimin e një varg projektligjesh, ndërsa ka miratuar Raportin e tij të punës për vitin 2013 dhe Planin e punës për vitin 2014

Komisioni për Buxhet e Financa është komision i përhershëm i Kuvendit. Në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësiave, i shqyrton të gjitha çështjet, që kanë të bëjnë me buxhetin dhe me financat në Kosovë.

Në ushtrimin e funksioneve të tij, Komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha ministrinë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke i përfshirë edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohej nga Komisioni.

Në sesionin pranveror të këtij viti, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka filluar punën me shqyrtimin e një varg projektligjesh. Kështu, gjatë muajit janar, komisioni ka shqyrtuar dhe përkrahur Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për hua dhe financim ndërmjet KfW Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSST, për përmirësimin e rrjetit të transmisionit.

Gjatë arsyetimit të marrëveshjes, zv/ministri i Financave, Naim Fetahu, ka thënë se ajo është lidhur në kuadër të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë, në bazë të cilës Qeveria e Kosovës do të huazojë nga KfW-ja 20.5

milione euro dhe do të pranojë nga Komisioni Evropian 3 miliona euro kontribut financiar. Këto mjete, sipas Fetahut, qeveria do t'i nën huazojë për KOST-in.

Po ashtu, zv/ministri Fetahu ka paraqitur edhe Projektligjin për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës, i cili, sipas tij, është hartuar me qëllim të rritjes së cilësisë së inspektimit dhe kontrollit të veprimtarisë Doganave të Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës.

“Ky projektligj përcakton fushëveprimin dhe parimet e këtij inspektorati, rregullon statusin e tij, përcakton rolin e Ministrisë së Financave në raport me inspektoratin, rregullon mënyrën e organizimit dhe funksionimit të inspektoratit etj. Në aspektin hetimor, projektligji përcakton kompetencat hetimore dhe inspektuese të Inspektoratit të Doganave dhe ATK-së, si dhe procedurat që duhet të respektohen gjatë zhvillimit të hetimeve dhe inspektimeve”, ka thënë ai.

Pas diskutimeve, komisioni ka përkrahur projektligjin dhe e ka proceduar atë për miratim në parim në Kuvend.

Komisioni ka përkrahur edhe Projektligjin për kimikate dhe atë për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, me amendamente të komisioneve funksionale.

Po në këtë fillim viti, komisioni ka miratuar Raportin e tij të punës për vitin 2013, si dhe Planin e punës për vitin 2014.

KOMISIONET E PËRHERSHME

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

E Mërkure, 29.01.2014

Në mbledhjen e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, të cilën e kryesoi z. Jasmina Zhivkoviç, kryetare e Komisionit, u shqyrtuan këto dy pr/ligje: - Pr/ligji nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave, me amendamentet e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK, dhe Pr/ligji nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-226 për Mbrojtjen e Konkurrencës me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri , si dhe Raporti me rekomandime për Pr/ligjin nr. 04/L-197 për kimikatet me amendamentet të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari dhe Planifikim Hapësinor. Pas debatit gjithëpërfshirës anëtarët e Komisionit e përkrahën procedimin e tre pr/ligjeve në Kuvend të Republikës së Kosovës.

Komisioni për Integritet Evropian

E Marte, 18.02.2014

Në mbledhjen e Komisionit për Integritet Evropian, të kryesuar nga kryetarja e komisionit, Vjosa Osmani, raportoi sot zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, lidhur me takimin e Dialogut të Strukturuar në Fushën e Sundimit të Ligjit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe përfaqësuesve të institucioneve të Republikës së Kosovës, si

dhe foli për pozicionin e qeverisë lidhur me rishikimin strategjik të BE-së për misionin e EULEX-it në Kosovë dhe për shumë çështje të tjera që u ngritën nga anëtarët të komisionit.

Më tej, në komision ka raportuar edhe u.d. i ministrit për Tregti dhe Industri, Bernard Nikaj. Në këtë takim ai ka raportuar lidhur me procesin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, duke u përgjigjur më tej edhe në pyetjet e anëtarëve të komisionit në çështje të ndryshme.

Në vijim të mbledhjes, anëtarët e Komisionit kanë shqyrtuar dhe përkrahur tri projektligje, me amendamentet e komisioneve funksionale, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së. Me këtë rast, ata përkrahën Projektligjin për transplantimin e indeve dhe qelizave, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, si dhe Projektligjin për Institutin e Kosovës për Administratë Publike.

Komisioni për Legjislacion

Në mbledhjen e datës 18.02.2014, Komisionit për Legjislacion, i kryesuar nga kryetari i komisionit, Arben Gashi, u shqyrtua Projektligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në bazë të draft-ligjit të spastruar, i proceduar nga Komisioni ad-hoc për reformën zgjedhore, të cilit i ka kaluar mandati. Me këtë rast, anëtarët të komisionit theksuan faktin se procesi për reformë zgjedhore po

JANAR - SHKURT 2014

përfundon suksesshëm. U paraqitën një sërë propozime nga anëtarë të komisionit dhe përfaqësues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe pasi përfunduan trajtimin e

këtij projektligji, u dakorduan që KQZ-ja të sjellë në komision rekomandime me shkrim, ndërkaq gjatë javës së ardhshme të votohet në komision.



Komisioni per Buxhet dhe Financa



Komisioni per integrimet Evropiane

KOMISIONET FUNKSIONALE

Komisioni për Punë të Jashtme

E Premte, 24.01.2014

Komisioni për Punë të Jashtme i drejtuar nga Albin Kurti, kryetar i Komisionit, shqyrtoi i Raportin e punës për vitin 2013. Komisioni ka vlerësuar se puna e komisionit ka qenë e frytshme. Ai ka mbajtur 21 mbledhje të rregullta, ka organizuar tryeza pune, ka përgatitur raporte me rekomandime, si dhe ka mbikëqyrur Projektligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare. Anëtarët e Komisionit kanë pritur anëtarë të komisioneve homologe parlamentare të vendeve të tjera dhe në cilësi të ndryshme kanë vizituar vende të tjera dhe kanë marrë pjesë në takime të ndryshme ndërkombëtare. Anëtarët e Komisionit kanë vlerësuar se ka pasur tendencë të shprehura hapur të mekanizmave të politikës së jashtme në Kosovë që ta marginalizojnë sa më shumë Komisionin për Punë të Jashtme, madje edhe për çështje që janë në kompetencë ekskluzive të tij. Në po këtë mbledhje, Komisioni ka shqyrtuar dhe ka miratuar planin dhe programin e punës për vitin 2014. Aty përfshihet roli i Komisionit në politikën e jashtme të Kosovës; promovimi i diplomacisë parlamentare; ratifikimi në bllok ose ndaras të traktateve ekzistuese, të cilat Kosova dëshiron t'i nënshkruajë; përcjellja e negociatave të udhëhequra nga Qeveria për bashkëpjesëmarrje të saj në traktatet e reja, si dhe nisja e debatin për ratifikimin e tyre; mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve për punë të

jashtme dhe për imunitetet diplomatike; mbikëqyrja e veprimeve të Qeverisë në planin e politikës së jashtme; shoqërimi i ministrin të Punëve Jashtme në takime të caktuara, të rëndësishme; bashkëpunimi me komisionet homologe të parlamenteve të vendeve të tjera; shqyrtimi i projektligjeve të propozuara nga MPJ; shqyrtimi i projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të MPJ-së, duke i rekomanduar Komisionit për Buxhet ta miratojë atë, etj. Në planin dhe programin e Komisionit për 2014 parashihet të ftohen për të raportuar ministri i Jashtëm, Hoxhaj, ministri për Diasporën, Makolli dhe zv. kryeministri Pacolli. Anëtarët e Komisionit janë pajtuar që brenda dy muajve të ardhshëm të ftohet për vizitë zyrtare Komisioni homolog i Kuvendit të Shqipërisë dhe të vihen kontakte me kryetarin e Komisionit për Evropën Juglindore të Parlamentit Evropian për një vizitë zyrtare në Bruksel.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së

E Mërkure, 29.01.2014

Në mbledhjen e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të kryesuar nga kryetari i komisionit Ahmet Isufi, u shqyrtua Raporti vjetor i FSK-së për vitin 2013. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant, Kadri Kastrati, njoftoi anëtarët e komisionit lidhur me progresin e arritur në zhvillimin e FSK-së për periudhën njëvjeçare të punës. Duke e

JANAR - SHKURT 2014

cilësuar vitin 2013 si një vit me shumë arritje për FSK-në, komandanti Kastrati tha se gjatë vitit të kaluar FSK-ja ka zhvilluar të gjitha aktivitetet sipas planit të paraparë, ndërkaq shpalosi të gjitha aktivitetet kryesore gjatë vitit 2013, si dhe foli për sfidat dhe planet e FSK-së gjatë këtij viti. Sfidë kryesore për FSK-në ishte dhe mbetet Rishikimi i Sektorit Strategjik të Sigurisë, si dhe plotësimi me pajisje dhe automjete i Njësisë rajonale të kërkim-shpëtimit dhe ngritja e Qendrës rajonale të ekselencës për kërkim-shpëtim. Anëtarët e komisionit theksuan se FSK-ja vazhdon të mbetet institucion i vlerësuar dhe se duhet të vazhdojë angazhimet drejt avancimit të mëtejshëm. Ata theksuan faktin se duhet të bëhet sa më shpejt ndryshimi i misionit, në mënyrë që edhe FSK-ja të jetë pjesë e NATO-s. Anëtarët e Komisionit po ashtu shqyrtuan dhe përkrahën edhe Planin e Punës së Komisionit për vitin 2014 dhe shpalosën programin e punës dhe aktivitetet tjera të komisionit gjatë këtij viti. Ndërkaq, lidhur me Projektligjin për Komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Policinë e Kosovës (hartuar nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së), i cili është dërguar për mendim në Qeverinë e Kosovës, anëtarët e komisionit u dakorduan që të kërkojnë informatë shtesë nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës lidhur me këtë çështje, meqë akoma nuk kanë marrë ndonjë informatë për procedimin e mëtejshëm të këtij projektligji.

Komisioni për Zhvillim Ekonomik Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

E Marte, 21.01.2014

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në mbledhjen e sotme diskutoi për Raportin e Punës së komisionit për vitin 2013. Duke e paraqitur këtë Raport, kryetari i komisionit, Zenun Pajaziti, sqaroi se në të janë pasqyruar në mënyrë statistikore aktivitetet e punës së komisionit për vitin që lamë pas. Sipas këtij raporti, komisioni në vitin e kaluar ka zhvilluar mbi 100 aktivitete, përfshirë këtu mbledhjet e mbajtura, monitorimin e ligjeve, tryezat e punës, rekomandimet dhe vizitat e realizuara në institucione të ndryshme. Në këtë takim, komisioni ka diskutuar edhe për procesin e privatizimit në Kosovë. Për tu informuar për së afërmi lidhur me këtë, komisioni mori vendim që të vizitojë Agjencionin Kosovar të Privatizimit (AKP)

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore Persona të Pagjetur dhe Peticione

E Marte, 21.01.2014

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, ka mbajtur sot mbledhjen e parë të sesionit pranveror. Në këtë takim, të kryesuar nga Suzan Novobërdali, kryetare e komisionit, u mor vendim për iniciimin e ndryshim-

KOMISIONET FUNKSIONALE

plotësimit të Ligjit për persona të zhdukur. Këtë vendim, komisioni e arsyetoi me faktin se ligji aktual për persona të zhdukur, nuk i mbron interesat e familjarëve të të zhdukurve. Komisioni formoi grupin punues për amendamentimin e këtij projektligji, të kryesuar nga Suzan Novobërdali. Anëtarë të këtij grupi do të jenë: Justina Pula, Kimete Bajraktari, Biserka Kostiq dhe Rita Hajzeraj - Beqa. Në këtë mbledhje është miratuar edhe Raporti i Punës së komisionit për vitin 2013.

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

E Mërkure, 29.01.2014

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale i Kuvendit të Kosovës, në mbledhjen e sotme, të udhëhequr nga kryetari Fikrim Damka, shqyrtoi Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, si dhe amendamentet e propozuara nga komisionet kryesore. Pasi analizoi të gjitha amendamentet e propozuara, komisioni përkrahu amendamentin 7 të Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili ka të bëjë me mënyrën e rregullimit ligjor të kushteve dhe kriterëve për pension kontribut pagues të moshës për punëtorët e Kosovës të larguar me dhunë nga puna apo të shpallur si tepriçë teknologjike pa bazë ligjore, në vitet 1989-1999. Komisioni e përkrahu projektligjin me amendamente dhe e procedoi për miratim në Kuvend.

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

E Mërkure, 26.02.2014

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, i kryesuar nga Ramë Vataj, kryetar i Komisionit, në mbledhjen e sotme shqyrtoi në parim Projektligjin për Provimin Përfundimtar dhe të Maturës Shtetërore, nr. 04/L-258. Me këtë Projektligj rregullohet mënyra e organizimit, përmbajtja, kushtet, kriteret dhe procedurat e provimit përfundimtar dhe provimit të maturës shtetërore. Gjatë debatit anëtarët e Komisionit u angazhuan në funksion të gjetjes së zgjidhjeve sa më të mira ligjore sipas standardeve ndërkombëtare në lëmin që rregullon ky Projektligj. Pas debatit, Komisioni përkrahu në parim këtë Projektligj dhe njëherësh e procedoi atë më tutje për shqyrtim në Kuvend.



Komisioni për Punë të Jashtme



Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale



Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së

Dëgjimi publik për mbikëqyrjen e Ligjit nr. 04/L-062 për Fshatin Hoça e Madhe dhe Ligjit nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit

E Marte, 18.02.2014

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, të cilin e ka kryesuar Jasmina Zhivkoviç, kryetare e Komisionit, mbajti diskutim publik për mbikëqyrjen e Ligjit nr. 04/L-062 për fshatin Hoça e Madhe dhe Ligjit nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit. Në diskutimin e cekur publik, krahas anëtarëve të Komisionit morën pjesë edhe ambasadori i Greqisë në Prishtinë, njëkohësisht edhe përfaqësues i Bashkësisë Evropiane për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe në Kosovë, z. Dimitris Moschopolos, përfaqësuesit e Ministrisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor, si dhe përfaqësuesit e ambasadës Zvicerane në Prishtinë, përfaqësuesit e OSBE-së dhe të ECMI Kosova.

Në këtë diskutim publik kryetarja e Komisionit, znj. Zhivkoviç, theksoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në bazë të mandatit dhe në emër të kompetencave që dalin nga fushë veprimtaria e tij, në prill të vitit të kaluar e formoi grupin punues për të mbikëqyrur në terren zbatimin e Ligjit për fshatin Hoça e Madhe dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit. Ky grup punues gjer më tani ka vizituar komunën e Prizrenit dhe atë të Rahovecit, në kuadër të mbikëqyrjes së këtyre ligjeve në terren. Duke shprehur shqetësimet për implementimin e këtyre ligjeve që thuajse është filluar nga zeroja, kryetarja Zhivkoviç, theksoi se gjatë mbikëqyrjes së

zbatimit të këtyre dy ligjeve të rëndësishme në terren ka mjaft probleme. Gjer më tani në komunën e Rahovecit nuk është formuar Këshilli për Implementimin e Ligjit nr. 04/L-062 për fshatin Hoça e Madhe, ndërsa në komunën e Prizrenit pjesërisht është i plotësuar me anëtarë ky Këshill për mbikëqyrjen e Ligjit nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit. Për ndryshe Grupi punues, si dhe përfaqësuesit e të dy komunave kanë kërkuar ndihmë dhe këshilla nga Ministria për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor në lidhje me implementimin e këtyre dy ligjeve.

Në vazhdim të këtij diskutimi përfaqësuesja e Ministrisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor theksoi se ministria i ka angazhuar ekspertët e UNDP-së në lidhje me përgatitjen e Projektit të udhëzimit administrativ për implementimin e këtyre ligjeve dhe se i njëjti do të duhej të jetë i gatshëm dhe i harmonizuar me të gjitha palët e interesuara, deri në mesin e muajit të ardhshëm.

Përfaqësuesi i UE-së për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe në Kosovë z. Dimitris Moschopoulos theksoi se UE është e interesuar që të ruhet trashëgimia kulturore dhe fetare në Kosovë, si dhe të ngrihet niveli i ruajtjes së saj. Ai theksoi se për zbatimin e këtyre ligjeve në terren UE ka formuar Këshillin mbikëqyrës dhe bën çdo gjë për implementimin e plotë të këtyre ligjeve në terren në bashkëpunim me organet lokale.

Në fund duke folur për atë se këto dy ligje janë në përbërje të Planit të Ahtisarit për Kosovën dhe për këtë shkak duhet që plotësisht të implementohet në terren, z. Moschopoulos tha se shpreson se në kohën më të shkurtër në komunat e Prizrenit dhe të Rahovecit do të zbatohen këto ligje në tërësi.

Në këtë diskutim publik anëtarët e këtij Komisioni e shprehen pakënaqësinë e tyre që për të satën herë edhe pse me kohë i

kanë bërë ftesë zyrtare, Ministri për Mbrojtjen e Ambientit dhe Planifikim Hapësinor, z. Dardan Gashi, si dhe dy kryetarët e komunave të Prizrenit dhe Rahovecit nuk iu kanë përgjigjur ftesës për të marrë pjesë në takimin e këtij Komisioni dhe se duhet kërkuar nga përfaqësuesit e këtyre komunave që sa më parë t'i formojnë këshillat për implementimin e këtyre ligjeve në terren.



Dëgjimi publik i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike

E Mërkure, 22.01.2014

Projektligji nr. 04/L-236/1 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të auditimit të Republikës së Kosovës, ishte temë diskutimi në dëgjimin publik të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Me këtë rast, kryesuesi i grupit të punës për shqyrtimin e këtij projektligji, nënkryetari i komisionit, Ramiz Lladrovci, sqaroi fillimisht se grupi i punës është në proces të shqyrtimit dhe amendamentimit të këtij projektligji, ndërkaq shtoi se do të shqyrtohen me kujdes të gjitha propozimet që dalin gjatë këtij dëgjimi publik. Lladrovci theksoi faktin se ky projektligj përbëhet nga 32 nene dhe rregullon organizimin, veprimtarinë dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare, si dhe përcakton fushëveprimin për auditimin e jashtëm të fondeve publike, ekzekutimin e buxhetit, etj. Ai tha se Komisioni i ka rekomanduar Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta përfshijë në buxhet edhe një shumë për implementimin e këtij projektligji. Zv/ministri i Financave, Naim Fetahu, tha se ky projektligj rregullon funksionimin e auditorit të përgjithshëm dhe se Ministria e Financave ka hartuar një projektligj tërësisht të ri që do të plotësojë të gjitha kriteret. "Ky projektligj përcakton fushëveprimin për auditimin e jashtëm të fondeve publike, ekzekutimin e buxhetit, përdorimin dhe qeverisjen e burimeve

publike, si dhe rregullon organizimin dhe kompetencat e ZAP-it", tha

Zv/ ministri Fetahu, duke shtuar se përmes këtij ligji Auditorit të Përgjithshëm i sigurohet një pavarësi e lartë, ashtu siç e parasheh Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe standardet ndërkombëtare të kësaj fushe. Ai sqaroi se përmes këtij ligji është rregulluar edhe mënyra e bashkëpunimit të ZAP-it me të gjitha institucionet publike, si dhe tashmë do të evitohen të gjitha paqartësitë ekzistuese sa i përket auditimit.

Ndërkaq, Auditori Gjeneral, Lars Lage Oloffsson, foli për rëndësinë e pavarësisë së auditorit, dhe shtroi një sërë çështjesh që duhet precizuar në këtë ligj. Ai foli për kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm sa i përket emërimit dhe menaxhmentit dhe se cilat duhet të jenë kriteret për ta bërë këtë në mënyrë sa më të drejtë.

Anëtarja e Komisionit, Valbona Dibra, pasi ngriti disa çështje në nene të caktuara të këtij ligji, shprehu edhe shqetësimin rreth auditimit të komunave. Ajo tha se do të ishte më mirë që ZAP-i të ketë stafin i cili do të merrej me auditimin e komunave, e jo këtë ta bëjë përmes kompanive private. Përfaqësues të Asociacionit të Komunave të Kosovës vlerësuan se auditimi i përgjithshëm në komuna dhe auditimi nga kompanitë private nuk kanë qenë në përputhje me njëra tjetrën. "Besojmë se do të ketë auditim direkt nga ZAP-i, e jo përmes kompanive private", theksuan edhe përfaqësues AKK-së. Ndërsa, anëtari

i komisionit, Adem Grabovci, tha se deputetët nuk guxojnë të lejojnë që të cenohet pavarësia e Auditorit të

Përgjithshëm. "Auditori i Përgjithshëm duhet të jetë i pavarur në vlerësimet dhe punët e veta", tha Grabovci.



Dëgjimi publik i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

E Mërkure, 22.01.2014

Zbardhja e fatit të personave të zhdukur, ishte temë diskutimi në dëgjimin e sotëm publik, organizuar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione. Në këtë mbledhje morën pjesë edhe përfaqësues të Komisionit qeveritar për personat e zhdukur, ata të Asociacionit të familjeve të të zhdukurve dhe përfaqësues nga shoqatat për të zhdukurit. Për ecurinë e monitorimit dhe nivelin e zbatimit të këtij ligji foli kryesuesja e grupit punues, Albana Gashi. Ajo njoftoi se janë vizituar shumë institucione të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e ligjit, si dhe kanë konsultuar shumë shoqata të cilat në domenin e veprimtarisë së tyre kanë zbardhjen e fatit të të pagjeturve. Po ashtu, deputetja Gashi njoftoi se gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të ligjit, kanë vizituar edhe lokacionet, ku është regjistruar numri më i madh i të zhdukurve. Me këtë rast, ajo përmendi vizitën në Krushë të Madhe dhe të Vogël, Meje, Prizren, Gjakovë dhe lokalitete të tjera. Në vijim të debatit folën përfaqësuesit e familjeve të të zhdukurve. Bajram Qerkini, nga shoqata, "Zëri i prindërve" bëri thirrje për plotësim- ndryshimin sa më të shpejtë të ligjit aktual. Ai vlerësoi se termi të "zhdukur", nuk përkon me këtë kategori, ndërsa benefitet që i ofron ligji i cilësoi të pamjaftueshme për nevojat e familjarëve të të zhdukurve. Ngjashëm është shprehur edhe Nusrete Kumnova, nga shoqata

"Thirrjet e nënave". Ajo shprehu bindjen se vendndodhja e të zhdukurve është e ditur, ndërsa duke hedhur kritika në përmbajtjen e ligjit, vuri në pah benefitet e pamjaftueshme që ofron ligji, sidomos për familjet që kanë më shumë se një të zhdukur. Se ligji nuk përmbush nevojat e familjarëve, është shprehur edhe Halit Berisha, nga shoqata " Shpresimi". Ai vlerësoi se ligji duhet të përmbajë edhe të drejtat e garantuara nga konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kritikave të ngritura gjatë debatit, u është përgjigjur përfaqësuesja e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Shqipe Krasniqi. Ajo sqaroi se Ministria në mënyrë korrekte përmbush obligimet ndaj kësaj strukture, ashtu siç është paraparë aktualisht me ligj. Në vijim ajo sqaroi se 286 familje gëzojnë benefitet e ligjit, e që kanë nga një të zhdukur, 17 familje me nga dy të zhdukur, gjashtë familje me tre dhe një familje me pesë të zhdukur. Ajo po ashtu sqaroi se për familjet që kanë më shumë se një të zhdukur, ligji ka paraparë që kompensimi të bëhet në harmoni me një përqindje të paracaktuar. Krasniqi po ashtu bëri të ditur se familjet që kanë më shumë se një anëtar të regjistruar si viktimë e luftës, nuk mund të aplikojnë në kompensimin prej 135 euro të përcaktuara me ligj. Këtë të drejtë, tha ajo, e kanë vetëm familjet, anëtarët e të cilave figuron dhe është në regjistrin e të zhdukurve. Rreth kësaj foli edhe përfaqësuesi i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, Agim Gashi. Ai tha se ligji me gjithë të metat që mund të ketë, ka

arritur të sigurojë interesim institucional për zbardhjen e fatit të të zhdukurve. Ai po ashtu njoftoi se në regjistrin e të zhdukurve, figurojnë persona, fati i të cilëve ende nuk dihet që nga koha para, gjatë dhe pas luftës. Në favor të ndryshimit të ligjit është shprehur edhe përfaqësuesi i Asociacionit të familjeve të të zhdukurve, Haki Kosumi. Ai bëri thirrje që kësaj kategorie ligji t'ia sigurojë benifitet, të cilat përmban Ligji për personat e dalë nga lufta. Për angazhimet e deritashme të Komisionit qeveritar për persona të zhdukur, foli kryetari i këtij komisioni, Preng Gjetaj, ndërsa vlerësoi se ligji aktual duhet të pësojë ndryshime. Ai tha se ligji duhet të

përcaktojë më qartas periudhën në të cilën janë evidentuar të zhdukurit. Ai foli edhe për rëndësinë e një regjistri unik për personat e zhdukur, për të cilin tha se duhet të përfshijë të gjithë dhe të jetë i pranueshëm nga të gjitha palët. Ai po ashtu, vlerësoi se benifitet të cilat aktualisht i siguron ligji janë të pamjaftueshme për familjarët e të zhdukurve. Kryetarja e komisionit, Suzan Novobërdali, ndërkaq, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje dhe i siguroi ata për mbështetje të pa rezervë për të gjitha institucionet dhe mekanizmat relevantë për zbardhjen sa më të shpejtë të personave të zhdukur.



VIZITO KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Kuvendi i Republikës së Kosovës vazhdon ta kultivojë dhe të rrisë transparencën e tij kundruall qytetarëve, duke u ofruar atyre qasje të vazhdueshme në punën e tij.

Në këtë funksion, Kuvendi ka krijuar një sërë lehtësirash për qasjen e publikut, duke e pasuar ueb-faqen me materiale shtesë.

Në kuadër të vegëzës “Shërbime për publikun”, është krijuar nënvegëza “Vizitoni Kuvendin”, i cili u mundëson qytetarëve adresimin e kërkesave për vizitë në Kuvend në mënyrë elektronike. Po në kuadër të kësaj vegëze, është krijuar nënvegëza “Xhiroja virtuale”, e cila ofron pamje dhe informacione për Kuvendin dhe punën e tij.

Planifikoni vizitën tuaj më herët, në mënyrë që të takoni përfaqësuesit tuaj të zgjedhur, të bëni një shëtitje nëpër ndërtesë, të shihni nga afër sallat ku mbahen mbledhjet plenare, mbledhjet e komisioneve etj.


Mësoni për përbërjen e Kuvendit dhe funksionet e tij,
Për komisionet dhe grupet parlamentare,
Për mënyrën e miratimit të ligjeve dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre.

PROCEDURAT PËR PARAQITJEN E KËRKESËS PËR VIZITË

- 1- Shkarkoni dhe plotësoni formularin(kërkesën) për vizitë në Kuvendin e Kosovës.
- 2- Formularin e plotësuar , dergojeni në adresën; musli.krasniqi@assembly-kosova.org
- 3- Kërkesa duhet të dërgohet 5 ditë para dates për vizitë në Kuvend.
- 4- Ju do të njoftoheni nga zyrtari përgjegjës i Kuvendit lidhur me kërkesën tuaj.

KOPJET ELEKTRONIKE TË FORMULARËVE

Formulari për vizitë në Kuvendin e Kosovës (shkarko)
Formulari për ndjekje të mbledhjes plenare (shkarko)



IFORMOHU RRETH HYRJES DHE QENDRIMIN NË KUVEND

Nëse kërkesa juaj për vizitë është miratuar, ju lutemi mbërrini në Kuvend s10 minuta para kohës së caktuar

Me rastin e paraqitjes në Kuvend , duhet të identifikoheni nëpërmjet dokumentit personal (qytetarët e huaj duhet të kenë me vete passaportën).

Duhet të kaloni nëpër kontrollin e sigurisë dhe të silleni në përputhje me rregullat e rendit në ndërtesën e Kuvendit

Gjatë ndjekjes së mbledhjes plenare, është i ndaluar çdo veprim që pengon punën e mbledhjes, si; folja me zë të lartë, përdorimi i telefonave, fotografimi, bartja e transparenteve të tjera, që në çfarëdo mënyre bien ndesh me rendin në mbledhje plenare ose e pengojnë apo e vështirësojnë punën e saj.

Nëse keni paraqitur kërkesa për të ndjekur punimet e mbledhjes plenare, për shkak të numrit të kufizuar të ulëseve dhe agjendës së Kuvendit, miratimi i kërkesës tuaj mund të marrë kohë.

Personi kontaktues Musli Krasniqi, zyrtar i lartë për marrëdhënie me publikun

E-mail: musli.krasniqi@assembly-kosova.org


Numri i telefonit; + 381 (0) 38 211 236

LEGJISLATURA IV (Sesiioni veror) 2014

SEANCA PLENARE 23.01.2014

Në mbledhjen plenare të datës 23.01.2014 midis pikave të tjera u zhvilluan edhe dy debate për procesin e privatizimeve. Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi i cili drejtoi seancën njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" ka kërkuar debat parlamentar lidhur me privatizimin e Fabrikës së Amortizatorëve në Zonën Industriale të Prishtinës. Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit që ta përgatisë një informatë lidhur me procesin e privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve dhe Kuvendit t'ia paraqesë këtë informatë.

Drejtuesi i seancës, z. Krasniqi, ftoi kryetarin e Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje Visar Ymeri të marrë fjalën.



V I S A R Y M E R I :
Kryetari i Grupit parlamentar të VV paraqiti një rezymë të procesit të privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve. Ai theksoi se Fabrika e Amortizatorëve, si dhe privatizimi i saj, i cili është udhëhequr nga AKP-ja, janë

shënjeshtë më i mirë i së vërtetës për ekonominë e Kosovës. Fabrika e Amortizatorëve, zhvillimi i saj, potenciali industrial që ajo paraqet, e tregojnë më së miri edhe rëndësinë e industrializimit të vendit, por edhe mundësinë e kapacitetit industrial e prodhues që e ka Kosova. Kjo ishte fabrika e vetme në rajon që prodhonte amortizatorë të llojeve të ndryshme. Fabrika e Amortizatorëve prodhonte vetëm

për eksport, ndërsa veturat franceze "Peugeot" pajiseshin me amortizatorët nga Prishtina. Pas luftës, punëtorët u kthyen në fabrikë dhe bënë të mundur që kjo fabrikë të funksionojë. Aty u bënë hapa të rëndësishëm për rimëkëmbjen e saj. Punëtorët arritën në kushte shumë të vështira dhe pa mbështetje minimale nga institucionet publike të Kosovës ta sanonin gjendjen në fabrikë dhe ta fillonin prodhimin. Që në vitin 2001, Agjencia Evropiane për Rindërtim e radhiti Fabrikën e Amortizatorëve në grupin e pesë ndërmarrjeve me potencialin më të madh në Kosovë për t'u rimëkëmbur dhe i ndau asaj një kredi prej 3 milionë markash gjermane, ose afërsisht 1,5 milion euro.

Po në atë kohë kolektivi i fabrikës arriti të vendosë kontakte edhe me partnerin e dikurshëm "Peugeot", të cilët shprehën interesim për vazhdimin e bashkëpunimit. Kështu, ndërmarrja në pronësi shoqërore filloi gradualisht t'i bëjë hapat e parë drejt kthimit në potencialin e vet prodhues. Privatizimi nga AKP-ja e ndërpreu këtë. Fabrika e Amortizatorëve u privatizua në vitin 2010.

Ky proces i privatizimit e tregon më së miri se si ka shkuar procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore të Kosovës dhe çfarë dëmsh i ka shkaktuar ky proces potencialit ekonomik të vendit. Ky proces i privatizimit e ndali zhvillimin e ndërmarrjes dhe e përcaktoi atë, nga fabrikë prodhuese në objekte dhe tokë.

Në të vërtetë, vetë shpallja dhe dokumentet për shitjen e fabrikës që ishin hartuar nga AKP-ja e ndanin së pari Fabrikën në dy pjesë, pra në dy objekte dhe parcela, dhe pastaj në fabrikë i ofronin për shitje vetëm asetet e paluajtshme, por jo edhe ato të luajtshme, e që ishin makineritë, pajisjet tjera që shërbejnë për prodhim, prodhimet e

JANAR - SHKURT 2014

gatshme, gjysmë prodhimet etj. , gjithsej 1 000 sosh, që ishin vlerësuar ta kapin vlerën rreth 93 milionë e 600 mijë marka gjermane.

Kjo ndarje fizike e kompanisë dhe shitja formale e objekteve dhe tokës pa makineri e pajisje krijonte kompani pa prodhim, objekte pa punëtorë. Kjo dëshmon se fabrika prodhuese nuk u shkatërrua si rrjedhojë e gabimit gjatë privatizimit, por që privatizimi e kishte këtë shkatërrim të prodhimit si qëllim. Është e njohur në botë kjo mënyrë e shitjes së kompanive me qëllim të shpërbërjes së tyre dhe përfitimit nga kjo shpërbërje. AKM-ja, dhe pastaj AKP-ja, si pasardhëse e saj, i shiti fabrikat e Kosovës për pjesë, pra sikur makinën e vjedhur.

- Në rastin e fabrikës së Amortizatorëve, kjo u bë në kundërshtim me vetë procedurat, rregullat dhe ligjin që e rregullon këtë çështje. Fabrika është shitur në një proces tenderimi një burimor, që është në kundërshtim me nenin 15.2 dhe pikën b të këtij neni, i cili e obligon Bordin e AKP-së që ta anulojë procesin e tenderimit, nëse në të nuk janë paraqitur më së paku 3 ofertues. Edhe atë nga ofertues, të cilët ishin nën hetime në kohën kur ofertonin për blerjen e ndërmarrjes. Pronarët e Kompanisë “Devolli” në vitin 2010, kur ofertuan dhe e fituan tenderin e blerjes së Amortizatorëve ishin nën hetime për përfshirjen e tyre në kontratën e “Z-Mobile” të nënshkruar me PTK-në. Më vonë, siç edhe e dini, këta u akuzuan zyrtarisht nga Prokuroria Speciale për këto vepra, për të cilat dyshoheshin.

AKP-ja asnjëherë nuk denjoi që ta bëjë hetimin e historikut të ofertuesve për blerjen e amortizatorëve, gjë që e ka pasur dhe e ka obligim ligjor.

Pra, ekziston një borxh ndaj punëtorëve të Kosovës për ndërmarrjen e tyre, e cila u është shitur dhe në anën tjetër, nuk ka para as AKP-ja, e as Qeveria e Kosovës, para të

cilat i kanë përfituar nga shitja e ndërmarrjes, për ta paguar këtë borxh.

Pra, paratë publike, ose fondi publik i Kosovës është në borxh ndaj këtyre punëtorëve.

- Një çështje tjetër që është me rëndësi në këtë proces të privatizimit është edhe përmbushja e kushteve të kontratës të privatizimit me ‘spin off -it’ special dhe fabrika e Amortizatorëve është shitur me procesin e ‘spin off -it’ special, që nënkupton se ka qenë e obliguar nëpërmjet kontratës që për pesë vjet pas blerjes ta vazhdojë afarizmin e njëjtë me atë që e ka pasur.

Raportin që na e ka dorëzuar AKP-ja, është dashur të raportojë për zbatim të kontratës nga blerësi, sepse në të nuk kemi mësuar asgjë të re, përveç se kanë listuar rregullat, shpalljet, proceset dhe thirrjet në nenet e ligjeve që e rregullojnë punën e AKP-së, dhe nuk ka asgjë të re për atë se çfarë ka bërë blerësi me ndërmarrjen dhe çfarë numri të punëtorëve ka mbajtur në punë, a e ka dhe në çfarë mënyre e ka vazhduar afarizmin. Pra, përgjithësisht, deri në ç’masë blerësi e ka respektuar kontratën që e ka nënshkruar me AKP-në për ‘spin off’-in special.

Të gjitha këto dhe shumë të tjera, dëshmojmë që ky proces i privatizimit është një proces i cili, përveç se e ka dëmtuar rëndë interesin ekonomik të Kosovës dhe të punëtorëve të fabrikës, është edhe një proces që e ka shkelur secilën rregull dhe secilin ligj të mundshëm që e mbulon çështjen e privatizimit dhe si i tillë duhet një vendim i Kuvendit që të suspendohet dhe të hetohet mirëfilli për ta kuptuar saktësisht se çfarë ka ndodhur me këtë proces të privatizimit.

Prandaj, ju kisha ftuar që rekomandimet që i kemi paraqitur t’i votoni në fund të këtij debati.

SEANCA PLENARE



ZENUN PAJAZITI:

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e mori deputeti Zenun Pajaziti, i cili tha ; - “Procesi i privatizimit po përcillet me debate të tilla dhe si proces ka

ngjallur gjithherë vëmendjen, jo vetëm të opinionit, por edhe të deputetëve, por po ashtu po përcillet edhe me ankesa të ndryshme nga punëtorët e ndërmarrjeve të ndryshme të privatizuara... Në rend të ditës kemi debate për privatizimin e dy ndërmarrjeve, që kanë qenë jashtëzakonisht të rëndësishme për ekonominë e vendit tonë, por po ashtu kemi pasur edhe protesta të punëtorëve që e kontestojnë në një mënyrë apo tjetër privatizimin dhe e kërkojnë të drejtën e tyre, të punësimit, ose kompensimin e tyre.

Partia Demokratike këtë proces e sheh si mjaft të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit dhe ne i inkurajojmë të gjithë, edhe deputetët, edhe të tjerët, që në mënyra të ndryshme të kontribuojnë që procesi i privatizimit të shkojë sa më mirë, të përmbillet sa më mirë dhe t'i kontribuojë sa më mirë gjithë procesit të zhvillimit sa më normal të vendit.

Ne si deputetë kemi obligim që të kujdesemi për të drejtën e punëtorëve. Këtu e kemi edhe një letër të Sindikatës së Punëtorëve të Fabrikës së Amortizatorëve, një letër e cila u është dërguar të gjitha institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Unë nuk e

pashë nëse figuron ndonjë informatë që është dërguar në dhomën e posaçme, e cila merret konkretisht me ankesat e punëtorëve dhe e tyre që e kontestojnë procesin e privatizimit dhe e kemi po ashtu një informatë nga Agjencia e Privatizimit si organ përgjegjës për gjithë procesin. Unë mendoj se, edhe nga ato që u sollën në letër, edhe në fjalën e përfaqësuesve që kanë nxjerrë këtë debat, duhet t'i ndajmë në dy segmente.

- E para, si proces i privatizimit a duhet, a është i kontestueshëm e a duhet ta nxjerrim nga fillimi këtë proces disavjeçar, i cili ka filluar edhe nga institucionet ndërkombëtare.

- E dyta, informacionet nganjëherë ngjajnë me informacione, të cilat janë informacione për organet e pavarura të drejtësisë. Edhe këto informacione janë të rëndësishme.

Pra ne duhet të gjitha informacionet që i kemi për shkeljet eventuale në këtë proces, t'i deponojmë në institucionet e drejtësisë, në mënyrë që të mos shkelen të drejtat e punëtorëve, dhe të mos abuzohet me pasurinë e vendit e vendit, e tje. Mendoj se rasti në fjalë nuk është i vetëm dhe ka rrugë ligjore për kontestimin dhe ndiqen nga të gjithë ata që mendojnë se ka pasur ndonjë shkelje.

Gjithashtu nuk duhet të bëjmë krahasime të tilla, të cilat janë në imazhin e atyre që kanë punuar, pasi procesi i privatizimit është një proces i cili ka filluar, është në përputhje me ligjet që i kemi në fuqi dhe nëse diçka e tillë kontestohet, ne duhet t'i nxjerrim, t'u kërkojmë organeve të pavarura. Në foltore mund të sjellim shembuj të ndryshëm. Ne si komision para dy vjetësh kemi vizituar edhe

JANAR - SHKURT 2014

një fabrikë tjetër, një pjesë të “Trepçës”, që prodhon bateritë dhe kemi parë që është një teknologji e re e cila ka prodhuar bateri të cilat asnjëherë nuk janë shitur në treg. Me të filluar lufta janë ndërprerë të gjitha dhe ato bateri edhe po të fillojë tash, nuk ka asnjë përdorues, sepse teknologjitë në mënyrë dramatike kanë ndërruar dhe janë të papërdorshme. Pra, imponohet gjithsesi që procesi i privatizimit t’u hapë rrugë investitorëve të huaj, t’u hapë rrugë investitorëve vendorë, t’u hapë rrugë që këto fabrika sa më shpejt të funksionalizohen.

Për rastin në fjalë, mendoj që ne duhet të kemi kujdes të mos përzihemi në organet që duhet t’i hetojnë rastet. Nëse kemi një rast kontestimor ose për ndonjë shkelje, duhet të kërkojmë nga gjykata e Dhoma e Posaçme dhe institucionet tjera të drejtësisë, të hetimit, të merren me këto. Dhe po ashtu, ne si deputetë të martën kemi një vizitë në Agjencinë e Privatizimit, duhet t’i shtrojmë të gjitha partitë politike, të gjitha pyetjet e mundshme për të gjitha rastet e privatizimit, në mënyrë që të kemi informacione nga dora e parë për këto çështje.

Po ashtu, dëshiroj të theksoj se e kemi një ligj dhe është kërkuar nga Agjencia e Privatizimit për plotësim-ndryshimin e këtij ligji.

Ju e dini që ka qenë edhe informata publike se Kuvendi i Kosovës e ka zvarritur mos ndryshimin e ligjit dhe si pasojë mos pagesën e obligimeve të punëtorëve. Ju e dini, që ka kohë që mungon një anëtar ndërkombëtar në bord dhe është pengesë për kryerjen e obligimeve të punëtorëve.

Ne si Kuvend duhet të shohim mundësinë që sa më shpejt t’i thërrasim të gjitha institucionet relevante, në mënyrë që ashtu siç e kemi ndryshuar ligjin para një viti, ta bëjmë ndryshimin e ligjit ose të ligjeve edhe këtë vit. Këto ditë në Kuvendin e Kosovës ka ardhur Projektligji për Dhomën e Posaçme, për ndryshim. Unë kërkoj që të gjitha institucionet ta shikojnë mundësinë, që edhe Ligji për privatizimin në paket të trajtohet tash, në mënyrë që të mos bëjmë vetëm ndryshime kozmetike, pasi është kompetencë jonë që këtë proces ta drejtojmë në mënyrën sa më të mirë, duke i shikuar ligjet sa më mirë, duke shikuar po ashtu edhe zbatimin e ligjeve sa më mirë.



ARBEN GASHI:

Tema e privatizimeve dhe futja e privatizimit në funksion të ekonomisë në Kosovë është një temë e cila shpesh është diskutuar këtu dhe në forume të ndryshme, sa i përket efektit që

po japin këto privatizime në ekonomi dhe gjithmonë ka rezultuar një konkluzion i përbashkët, se pritshmëritë dhe efektet nuk janë në të njëjtën linjë dhe realisht, pasoja që është prodhuar nuk ka qenë në funksion të ekonomisë dhe të interesave të punëtorëve dhe qytetarëve të Kosovës. Si rezultat i kësaj kemi një gjendje ku ekonomia e Kosovës sot është në një situatë të vështirë dhe institucioni i cili është

SEANCA PLENARE

dashur të merret me formatizimin dhe riformatizimin e kompanive, ndërmarrjeve publike, ndërmarrjeve shoqërore e tjerë nuk ka mundur të japë rezultat. Në këtë rast, Qeveria e Kosovës për ndërmarrjet publike dhe Agjencia për Privatizim e Kosovës për ndërmarrjet shoqërore.

Ne jemi në situatë sot, ku po diskutojmë për një kërkesë konkrete të bërë nga Lëvizja “Vetëvendosje”, për ta shqyrtuar një proces të privatizimit. Si princip, shqyrtimi i procesit të privatizimit në nivele politike është i papranueshëm, mirëpo, realisht jemi në një situatë ku Agjencia për Privatizim si një organ i tejpolitizuar dhe jofunksional ka futur në krizë edhe ndërmarrjet shoqërore, por edhe ekonominë e Kosovës.

Dhe, le të kthehemi te pika kryesore që kemi për diskutim sot këtu dhe funksioni që unë kam marrë sot, që në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, t'i jap vlerësimet lidhur me rekomandimet që kanë dalë nga Lëvizja “Vetëvendosje” dhe qëndrimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Mendoj se rekomandimi i parë, ku kërkohet që të bëhet auditim ligjor dhe financiar nga një subjekt ndërkombëtar është problematik në vetvete, sepse nuk caktohet qartë se kush do ta rekrutojë Agjencinë Ndërkombëtare, kujt do t'i japë llogari kjo agjenci ndërkombëtare dhe kush do ta paguajë këtë agjenci ndërkombëtare?

Pika e dytë, që kërkon që Agjencia Kosovare e Privatizimit të pezullojë kontratën e tenderimit të privatizimit me ‘spin off’ special për ndërmarrjen shoqërore Fabrika e Amortizatorëve, mendoj që është kompetencë e Gjykatës dhe nuk mund të

bëhet nga niveli politik, siç është Kuvendi i Kosovës.

Dhe pika e tretë, propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” që Kuvendi i Kosovës të ngre Komision Hetimor Parlamentar, mendoj se seanca nuk mund të ngre Komision Hetimor parlamentar në këtë mënyrë. Mirëpo, parimisht ne jemi dakord që të marrim veprime dhe bashkërisht konkluzionet të riformulohen kështu:

- Të formohet Komision Hetimor Parlamentar për hetimin e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore Fabrika e Amortizatorëve dhe ndërmarrjes shoqërore Amortizatorët, Ndërtesa Administrative; ndërsa, pika dy të formulohet kështu: “Të auditohet dhe vlerësohet nga Auditori Gjeneral si auditor i autorizuar procesi i privatizimit të ndërmarrjes shoqërore Fabrika e Amortizatorëve, Prishtinë dhe ndërmarrjes shoqërore Amortizatorët, ndërtesa administrative, të gjeturat e auditorit të vihen në funksion të Komisionit Hetimor Parlamentar, para se procesi i hetimit parlamentar të përfundojë”.

Në këtë mënyrë, ne krijojmë lidhjen logjike, formojmë Komision Hetimor parlamentar për të cilat ne si grup parlamentar japim nënshkrimet dhe në të njëjtën kohë bëjmë auditim dhe caktojmë, se kush është auditori i autorizuar në Kosovë për të bërë auditim edhe ligjor edhe financiar, nëse ka nevojë, çfarëdolloj auditimi. Dhe, këto të gjeturat e auditorit vihen në funksion të Komisionit Hetimor. Kështu kemi rrjedhë logjike, kemi edhe qëndrueshmëri në aspektin logjik, logjistik dhe ligjor dhe kemi një pasojë, e cila pastaj mund të prodhohet. Dhe, pasoja që

JANAR - SHKURT 2014

mund të prodhohen janë konkluzionet e auditorit, të cilat i bashkëngjiten raportit të Komisionit Hetimor, i cili vjen në Parlament dhe Parlamenti vendos se çka do të rekomandojë në fund si masë finale. Ndërsa, mënyra se si është propozuar, mendoj se është e gabueshme, sepse nuk dihet se kush do ta rekrutojë një agjenci ndërkombëtare e cila do të bëjë vlerësimin, kush do ta paguajë, kujt do t'i japë llogari dhe po ashtu, pezullimi i kontratave është kompetencë gjyqësore e jo kompetencë politike. Dhe, në këtë rast mendoj se ky formulim, besoj edhe në mirëkuptim me "Vetëvendosjen" do të përkrahet, ndoshta, munde të ketë ndonjë finesë, që dakordohet më tutje dhe bashkërisht të bëjmë një komision hetimor parlamentar, t'i kërkojmë Auditorit Gjeneral të bëjë auditimin e kompanisë dhe ngjarjeve që kanë ndodhur edhe në aspektin ligjor dhe atë financiar, t'i kemi bashkërisht këto, të nxjerrim konkluzionet, sepse kështu veç po e paragjykojmë paraprakisht. Mendoj se konkluzionet, rekomandimet që i lexova këtu në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës janë të qëndrueshme dhe besoj që bashkërisht mund të ecim përpara.



ARDIAN GJINI;

Kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës fjalën e tij e nisi: - Fillimisht, më duhet të them se është lehtë që të dalim në foltore të Kuvendit dhe të flasim se sa keq ka shkuar privatizimi...

Mund t'ju them se në shumicën e rasteve të ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara ka probleme, në shumicën e rasteve ka ndërhyrje dhe në shumicën e rasteve ne mund të themi, se privatizimi nuk ka shkuar ashtu siç kemi dëshiruar të gjithë që të shkojë. Përgjigjen kryesore që e kemi marrë në shumicën e rasteve, është se kjo është ekonomi e tregut dhe çmimin e cakton tregu. Në shumë raste asetet që janë gjetur brenda ndërmarrjeve e kanë tejkaluar shumëfish vlerën e shitjes të ndërmarrjes. Është e vërtetë, krejt është e vërtetë! Mirëpo, ne këtu duhet të japim përgjigje. Kuvendi duhet të jep përgjigje, se çfarë ka ndodhur me privatizimin. Ne i kemi disa probleme që janë parimore. Çështja e parë është kjo, nëse Kuvendi ndërton praktikë hetimore për ndërmarrje të veçanta do të dalin probleme. Problemi i parë është që do t'i frikësojmë njerëzit për të investuar, ose për të blerë, sepse ende ka ndërmarrje që nuk janë privatizuar, edhe nëse janë të ndershëm. Ne kemi të drejtë ta hetojmë të gjithë procesin e privatizimit, por nëse i ndajmë rastet një nga një, atëherë ne bëjmë gabimin

SEANCA PLENARE

e dytë, Kuvendi nis të marrë role të gjyqësorit. Tek rekomandimet të cilat i kemi marrë para vetes sot, ka elemente të cilat lirisht mund të quhen “aktvendim”, jo “rekomandim”.

Aleanca nuk është e gatshme të lëshohet në këtë drejtim. Ne jemi të interesuar që procesi i privatizimit të paktën të fillojë të duket transparent, por, nuk jemi të gatshëm që të marrim ose t'i mbështesim vendimet të cilat Kuvendin e vendosin në pozitë të marrjes së aktvendimeve.

Çështje tjetër është se ne do të diskutojmë për privatizim sot prapë, është edhe një ndërmarrje tjetër. E dimë çka ka ndodhur aty! Ka qenë proces brutalisht i gabueshëm, e kemi vendimin e Gjykatës Kushtetuese, mirëpo, po më duket që jemi duke e përdorë Kuvendin për punë të cilat nuk i takojnë, për shkak se instrumentet tjera të shtetit nuk po punojnë.

Në fund të fundit, më duhet t'ju them se nëse grupet parlamentare arrijnë t'i rifrazojnë rekomandimet në mënyrë që ta kryejmë punën tonë, ta hetojmë të gjithë procesin e privatizimit si proces, nëse është nevoja, krejt materien që e kemi për këtë rast edhe për rastin i cili do të diskutohet në pikën tjetër të rendit të ditës, t'ia përcjellim tubë si dosje Gjykatës. Ne pajtohemi që Kuvendi të thotë, po ia përcjellim gjykatës. Ajo le ta kryejë punën e vet, Prokuroria le ta kryejë punën e vet.

Këto janë qëndrimet e Aleancës, këto janë mendimet e Aleancës, se në parim ne jemi për privatizim, nuk jemi kundër privatizimit. Ne mendojmë se kapitali privat duhet të operojë si biznes në Kosovë, jo si kapital publik. Shembuj për këtë ka në tërë botën, Kosova nuk ka nevojë ta shpikë rrotën. Është zbuluar ajo rrotë dhe dihet se ku kanë shkuar vendet që kanë insistuar të mbajnë sistem të ndërmarrjeve shoqërore.



RAMIZ LLADROVCI

Ne sot po debatojmë për privatizimin e Fabrikës së Amortizatorëve, nismë kjo nga Lëvizja “Vetëvendosje”. Procesin e privatizimit i filluar me ndihmën e çmuar të ndërkombëtarëve dhe më pas i vazhduar nga

institucionet e Kosovës, padyshim që ka qenë tema më e nxehtë e debatit dhe kritikës përgjatë gjithë zhvillimit të saj. Në këtë kontekst dhe për të evituar perceptimet negative të opinionit publik lidhur me dyshime aferash dhe keqpërdorimesh është i nevojshëm një konsultim paraprak me të gjithë ju, kolegë deputetë, dhe do të kishte qenë mirë formimi i një komisioni hetimor për të vlerësuar të gjithë procesin e privatizimit, që nga themelimi i AKM-së, sidomos procesi të privatizimit nga ana e AKP-së, që mendojmë se është degraduar në masë të madhe në të gjitha drejtimet.

I gjithë opinioni i gjerë në Kosovë flet dhe dëshiron të dijë, se çka është ndërmarrë deri tani nga ana e Prokurorisë së Shtetit, përcjellja me probleme e transformimit nga AKM-ja në AKP, e përcjellë me zhdukjen dhe djegien e dokumentacioneve zyrtare të privatizimit. Qytetarët e Kosovës besojnë se AKP-ja qëllimisht nuk ka pasur një bashkëpunim me Policinë e Kosovës në drejtim të përmbushjes me kohë të kriterit për verifikimin e blerësve të ndërmarrjeve shoqërore.

Kur jemi te kjo çështje, dua të theksoj se në Kosovë flitet se janë blerë dhe privatizuar shumë ndërmarrje shoqërore nga pronarë të cilët kanë pasur ndjekje penale, siç është rasti i blerësit të Fabrikës së

JANAR - SHKURT 2014

Amortizatorëve, apo të atyre paratë e të cilëve e kam thënë edhe në seancën e kaluar, që janë me prejardhje të dyshimta, si ato nga prostitucioni, droga, korrupsioni dhe krimi i organizuar.

Duke pasur parasysh përgjegjësinë time si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, konsideroj se vetëm një debat i tillë nuk mjafton për AKP-në, kur kemi parasysh përgjegjësinë totale të këtij bordi të drejtorëve dhe këtij menaxhmenti, i cili është i korruptuar dhe i cili ditë e më tepër po e dërmon ekonominë e vendit.

Bordi i Drejtorëve dhe menaxhmenti i AKP-së duhet të na sqarojë se cilat kanë qenë arsyet e ndryshimit të rregullave të tenderit me rastin e privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve. Është shumë e habitshme se si i njëjti blerës i ndjekur penalisht, shpallet ofertuesi fitues në kundërshtim me rregullat e tenderit, të cilat ndryshohen ndërkohë nga Bordi i Drejtorëve dhe menaxhmenti i AKP-së.

Janë të dyshimta shumë nga rastet e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, siç janë fabrika e "Ballkanit" të Suharekës, Fabrika e Radiatorëve në Gjilan, "Sharri" në Han të Elezit e të tjerë. Këto shitje të kundërligjshme i vërteton edhe raporti i ZAP-it se i tërë procesi i privatizimit të këtij gjiganti ekonomik ishte përcjellë me shkelje ligjore serioze dhe në dëm të shtetit të Kosovës.

Shitjet me anë të 'spin off'-ëve specialë kanë shkaktuar skandale të mëdha, siç është edhe ky i fundit i Grand Hotelit. Nuk dihet se si është bërë rishitja e ndërmarrjes shoqërore e Fabrikës së Duhanit në Gjilan, pa tender dhe pa procedurë transparente e konkurruese. Po ashtu, kemi një prej privatizimeve më kontestuese gjatë vitit 2012, atë të shitjes me negociata dhe pa tender të aseteve të ndërmarrjes Kosova Elektro në qendër të Prishtinës.



ALBIN KURTI:

Ne jemi të interesuar që të zhvillojmë debate parlamentare për privatizimin e të gjitha fabrikave në Kosovë. Fakti që në këtë vit kemi filluar me Fabrikën e

Amortizatorëve nuk duhet të interpretohet se çdo privatizim tjetër është më pak i rëndësishëm se ky, se ta zëmë privatizimi i 'Ferronikelit' paska peshë më të vogël. Sigurisht që jo! Mbase filluam me amortizatorët, sepse amortizatorët fillojnë me shkronjën "A". Kaq!

Por, e kemi ndërmend dhe e konsiderojmë të drejtë dhe të duhur që të merremi me privatizimin e të gjitha fabrikave, privatizim ky i kryer nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, e më herët nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit. Më vjen mirë që gjuha e punëtorëve që na e dërguan materialin ka nisur t'i përdorë shprehjet e duhura. Si për shembull "kriminalitet i jakave të bardha" dhe "kapje e shtetit", se me të vërtetë është kështu. Bëhet fjalë për kriminalitet të "jakave të bardha" dhe bëhet fjalë për "kapje të shtetit" dhe kur punëtorët ankohen se është kapur shteti, t'u thuash 'shkoni te gjykatat' është në rastin më të mirë cinizëm.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, jo vetëm që e ka lejuar privatizimin, por ajo e ka nxitur, organizuar dhe ekzekutuar atë. Kriminaliteti i "jakave të bardha" nis me AKP-në, por nuk përfundon me të. Sigurisht që kur po bëhen privatizimet në Kosovë përgjithësisht nuk po përfillen rregullat, mirëpo para se ta arrijnë këto e kemi vetë privatizimin që është ilegal, meqenëse as sot

SEANCA PLENARE

e kësaj dite nuk kemi Ligj mbi privatizimin. Prandaj, me të drejtë është më e drejtë është që privatizimi të quhet “shitje” se sa “privatizim”.

Mirëpo, edhe shitja e këtillë që nuk është privatizim, kur i kemi parasysh çmimet e shitjes, na del që është falje dhe jo shitje.

Ndërkaq, kur i shohim asetet e shitura del që nuk është as falje, por dhënie e mënyrës, që populli ynë e quan “më lirë se badihava”. Njëra pjesë e ndërmarrjes së ndarë në dysh nga AKP-ja u dha për 2 milionë euro, e pjesa tjetër për 5 milionë euro, ndërkohë që Sindikata e Punëtorëve i referohet një raporti, sipas të cilit vetëm vlera e 1 mijë aseteve të luajtshme, të cilat fare nuk janë regjistruar, kap shumën prej 93 milionë markash gjermane.

Në këto të paregjistruarat bëjnë pjesë makineri dhe pajisje të tjera që shërbejnë në procesin e prodhimit, prodhime të gatshme dhe gjysmë prodhime, si dhe pasuri të tundshme. Nga pikëpamja e këtij privatizimi të AKP-së me rastin e privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve, pasuria e luajtshme nuk është pasuri, sepse thjesht ajo që lëviz nuk është. Vetëm ajo që nuk lëviz është. Privatizimi i këtillë është nihilist ndaj prodhimit, sepse ua mohon edhe vetë ekzistencën makinerive prodhuese.

Pra, së pari nuk kemi privatizim, por kemi shitje. Së dyti, nuk kemi as shitje, por kemi falje dhe, së treti, nuk kemi as falje, por dhënie më lirë se badihava.

Nga mënyra e AKP-së që pas pavarësisë e vazhdoi atë të AKM-së nuk është përjashtuar e nuk është kursyer as Fabrika e Amortizatorëve. Tjetërsimi i këtillë i ndërmarrjes, ku çmimi i shitjes nuk krahasohet me atë të aseteve, pra të pasurive që përmban ndërmarrja, nuk mund të bëhej pa një zhvlerësim paraprak. Akti kryesor i zhvlerësimit është ndarja e ndërmarrjes, ndarja e ndërtesës administrative prej fabrikës. Pra,

ndërmarrja si trup ekonomik së pari copëtohet dhe mandej i shiten gjymtyrët pors i një kufome.

Kjo që u quajt “privatizim” e nënkupton vrasjen paraprake të ndërmarrjes, e cila nga një jetë ekonomike shndërrohet në trup të vdekur e të ndarë sipas gjymtyrëve. Dikush mund të thotë që fabrika është shitur pjesë-pjesë si një automobil, mirëpo këtu ka një gjë që nuk duhet ta harrojmë dhe një keqinterpretim që e zhbën këtë analogji. Së pari, njëmend një automobil mund të shitet pjesë-pjesë, por jo që të bëhet sërish automobil, por që t’u shërbejë automjeteve të tjera dhe, së dyti, fabrika nuk mund të krahasohet me automobilin meqenëse fabrika e prodhon automobilin e nuk është vetë automobil. Automobili është mall, fabrika prodhon mallra. Kjo do të thotë që AKP-ja dhe kjo Qeveri fabrikat i ka konsideruar gabimisht dhe unë besoj me dashakeqësi si mallra. Prandaj, këto privatizime të AKP-së nuk mund ta dinamizojnë ekonominë tonë, sepse ato, në vend se ta shndërrojnë pronën në kapital, në fakt e shndërrojnë kapitalin në pronë. Kjo dhënie më lirë se badihava ngjan për tri arsye kryesore.

E para, pasuria e Kosovës konsiderohet më shumë si barrë se sa si shans. E dyta, ndërmarrjet prezantohen si aset që mund t’i ndërrohet destinimi, e jo si kapacitet zhvillimor apo organizatë e punëtorëve. Dhe, e treta, privatizimi nuk është pjesë e ndonjë vizioni më të gjerë e më afatgjatë zhvillimor, por privatizimi është principi i instaluar në formën e një të vërtete universale. Privatizimi i këtillë është bindje ideologjike. Pra, ata që po privatizojnë janë ideologjikë në ndërmarrjen e tyre të eliminimit të ndërmarrjeve shoqërore-publike, e jo ne që po e kundërshtojmë këtë privatizim, të cilit nuk po ia shohim as drejtësinë, e as dobinë. Deputetë të Kuvendit të Kosovës, Ky material voluminoz që na e kanë sjellë

JANAR - SHKURT 2014

ne deputetëve punëtorët e Fabrikës së Amortizatorëve është i njëjti material që ju e keni nëpër CD-të, të cilat gjithashtu u janë shpërndarë dhe ky material është krejt çka i nevojitet Prokurorisë. Në vendet e zhvilluara demokratike perëndimore, prokuroritë hetojnë e hulumtojnë gjerë e gjatë e shumë thellë, në mënyrë që ta ndërtojnë rastin e tyre. Prokuroritë në Kosovë nuk kanë nevojë as të hetojnë, as të hulumtojnë. Ja ku e kanë materialin! Thjesht nga zyra e tyre do të mund ta kryejnë krejt punën, por ja që nuk e bëjnë një gjë të tillë, sepse thjesht, edhe Prokuroria, edhe Gjyqësia jonë, si ajo vendore, po ashtu edhe ndërkombëtare, nuk udhëhiqet nga logjika e drejtësisë për qytetarët dhe të drejtat e qytetarëve, por nga ajo e menaxhimit të krizës dhe stabilitetit afatshkurtër politik.

Nga këto tre vjet sa jam në Kuvendin e Republikës së Kosovës është përshtypja ime e fuqishme që deputetët e Kuvendit kur nuk duan të merren me një padrejtësi, ose le të themi kur nuk janë mjaftueshëm të zemëruar me një padrejtësi, ose kur nuk e përfaqësojnë sinqerisht interesin publik, thonë se kjo gjë u përket gjykatave. Ndërkohë, që të gjithë e dinë që gjykatat përgjithësisht po merren me drejtësinë. Sindikata e Punëtorëve këtu tregon qysh as gjykata, as Prokuroria, as Qeveria, as faktorët ndërkombëtarë nuk po e kryejnë detyrën e tyre dhe shpresa e fundit e kësaj sindikate është Kuvendi i Republikës së Kosovës.


Prandaj, edhe këtu e kemi nisur këtë debat. Ndërkaq, të gjithë ata që u thonë tash punëtorëve "shkoni në gjykata", po e harrojnë një gjë, ose s'po duan ta kuptojnë një gjë, se në atë stacion tashmë kanë qenë punëtorët, e kanë kaluar atë stacion. Ata kanë ardhur te Kuvendi, sepse institucionet kompetente s'po funksionojnë dhe Kuvendi është organi më i lartë në Republikën tonë parlamentare. Prandaj, është më shumë se

legjitime që ne të merremi me këtë çështje dhe le të mos harrojmë që e kemi edhe situatën tjetër me pasojën e njëjtë. Merr vendim gjykata, por nuk zbatohet! Nganjëherë s'merr vendim e nuk vepron, e nganjëherë merr vendim të duhur, por ja që nuk zbatohet ai, dhe sërish punëtorët s'kanë se ku të shkojnë tjetër kund, përveçse në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Për shembull, shikoni pikën 36 në material, në faqe 11, ku tregohet shumë mirë qysh punëtorët paditës të ndërmarrjes shoqërore Fabrika e Amortizatorëve në Prishtinë, në gjykatën kompetente kanë paraqitur padi për kompensime të të drejtave të punës nga suspendimi i tyre, nga përjashtimi nga puna, që e kanë përjetuar pas suprimimit të autonomisë së Kosovës, në mars të vitit 1989, dhe Gjykata Komunale në Prishtinë, në aktgjykimin e datës 17 nëntor 2010 e ka aprovuar kërkesën e punëtorëve paditës në shumën totale të kërkesave të tyre prej mbi 18 milionë euro. Më pas, kishim edhe dy procedura të tjera nga marrëdhënia e punës. Përlllogaritur bashkë detyrimet e ndërmarrjes shoqërore Fabrika e Amortizatorëve dhe AKP-së ndaj punëtorëve arrin shumën mbi 22 milionë euro. Mirëpo, e dini çka? Krejt kjo është shitur për 7 milionë! Tash punëtorëve ua kanë borxh 22 milionë. Ku të merren 15 milionë euro? Dhe, ku të vijnë këta punëtorë për këtë diskrepancë prej 15 milionë eurove? Po sërish në Kuvendin e Kosovës. Ku tjetër?! Dhe, nëse ne themi që Gjyqësori duhet të jetë i pavarur, ai nuk duhet të jetë i palidhur nga Kuvendi e nga Qeveria, sepse mos harroni - gjykatësit kanë dhënë betim te Presidentja, e cila është presidente e një republike parlamentare, që është zgjedhur këtu.

Gjërat janë të lidhura dhe gjykata është e pavarur nga Ekzekutivi, mirëpo mos harroni që ajo nuk është e pavarur nga shteti. E këtu sot po flasim për shtetin, çfarë shteti duam.

SEANCA PLENARE



JAKUP KRASNIQI

Çështjen të cilën, t'ju them drejt, ne në Grupin tonë Parlamentar e kemi diskutuar gjerë e gjatë, pa ardhur këtu, po përtej kësaj unë kam një mendim dhe plus u përpoqa t'ju dëgjoj këtu

kujdesshëm të gjithëve.

Është interesant se ne jemi një Kuvend, proceduralisht kjo mënyrë është e drejtë e kërkimit të një diskutimi të këtij lloji i çfarëdo grupi parlamentar, kalon nëpër të gjitha instancat, Kryesi dhe tutje dhe tash këtu në bankat e Kuvendit, në vend që të përqendrohemi në këtë pikë që e kemi, tendenca është e madhe e ikjes nga pika konkrete, në fillim e grupeve tjera kah fundi totalisht edhe vetë "Vetëvendosjes", që ikët, ju në histori e në gjeografi e në filozofi e politike që ishit kaq larg të kësaj teme. Domethënë të gjithë e kanë merakun, nëse ju jep diçka konkrete, kalojnë në të përgjithshmen, po ua dhe të përgjithshmen - thonë e pse kjo është, po mungon konkretja, s'jep rezultat. Pak a shumë po hidhemi këtu dhe mua më duket që nuk është edhe fort mirë, sepse është tepike.

Ajo që edhe pak më shumë mua më integroi është problemi i njëfarë notimi, vetëmohimi të kolektivitetit nga këndi personal, të cilin unë edhe si drejtues edhe si deputet më duhet të tërheq vërejtje. Asnjëri mos t'i lëvdojë të gjithë kolektivisht kur është entuziast, si edhe kur është i rezignuar - të mos të thotë që ky Kuvend s'vlen. Unë këtë an-blok s'e pranoj në asnjërin variant, bile

vetveten e përjashtoj prej kësaj në çdo mënyrë, sepse kaq kam të drejtë, nëse për ju të tjerët s'kam, për veten kam.

Tutje. Ju duhet t'ju përkujtoj edhe një herë qysh janë procedurat, çka ka brenda në këtë mocion edhe procedura. - Ligji për hetim parlamentar, neni 4, pika 2 e jep rastin qysh formohet domosdoshmërisht, edhe e treta ky tip i komisionit hetimor. Nëse janë 40 firma, domethënë 1/3 e Kuvendit të Republikës së Kosovës bën kërkesë dhe ajo domosdoshmërisht kalon në rast se, a, në rast se është shumica brenda. Dhe, ajo edhe më e rëndësishmja, ky komision s'mund të punojë më shumë se 6 muaj, ky komision nuk krijohet më vonë se 6 muaj para se të mbarojë mandati, këto t'i keni parasysht. Dhe po rezymo. Nga ajo që pashë unë, domethënë janë rekomandimet e "Vetëvendosjes", është një propozim i modifikuar i LDK-së, është hedhur ideja që të bëhet Komision parlamentar për të gjitha ndërmarrjet që janë privatizuar me 'spin off' special, që artikuloi Fatmir Limaj dhe është të bëhet komision hetimor për një listë ndërmarrjesh, e para mbas kësaj do të jetë "Ballkani" që është propozim i Burim Ramadanit.

Unë rezymova, tash është e deputetëve të shkojnë tutje.

Në përfundim të debateve fjalë e mori përsëri kryetari VISAR YMERI, I cili u shpreh se me diskutimin dhe konsultimin me disa prej deputetëve dhe me Grupin Parlamentar të LDK-së, rekomandimet përfundimtare kanë pësuar një lloj modifikimi, të cilat po i lexoj

JANAR - SHKURT 2014

1. Të formohet Komision Hetimor Parlamentar për hetimin e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, pra Fabrikës së Amortizatorëve dhe i asaj të Amortizatori, ndërtesa administrative.

2. Të auditohet dhe të vlerësohet nga Auditori i Përgjithshëm procesi i privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve dhe ndërmarrjes shoqërore 'Amortizatori' - Ndërtesa Administrative, si dhe të gjetura të auditimit të vijnë në funksion të Komisionit

Hetimor Parlamentar para se procesi i hetimit parlamentar të përmbyllet.

3. Agjencia Kosovare e Privatizimit ta pezullojë kontratën me tenderët e privatizimit me 'spin off' special për Fabrikën e Amortizatorëve dhe ndërmarrjen shoqërore Amortizatori për shkak të mos përbushjes së kushteve të kontratës deri në përmbylljen e procesit të auditimit dhe atij hetimor.

Për shkak të mungesës së kuorunit të duhur për votim, u vazhdua me pikën e pestë të rendit të ditës



17.02.2008 - 17.02.2014

“Ne kemi nevojë të mësojmë nga shembujt e mirë, por edhe të këqij të të tjerëve, kemi nevojë të mësojmë të kaluarën për të mos na u përsëritur historia, as si farsë, as si tragjedi, kemi nevojë të mbajmë gjallë amanetin e themeluesve të pavarësisë së Kosovës, për lirinë, për nderin dhe begatinë e vendit e popullit që përfaqësojmë”.

dr. Jakup Krasniqi



Seancë Solemne me rastin e 6 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës

Fjala e kryetarit të Kuvendit
z. Jakup Krasniqi në hapje të
Seancës solemne të Kuvendit
për nder të përvjetorit të gjashtë
të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës

*E nderuar presidente e Republikës së Kosovës,
zonja Atifete Jahjaga
I nderuar Kryeministër, zoti Hashim Thaçi
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues diplomatikë në Kosovë
Të nderuar kolegë deputetë
Të nderuara familje të dëshmorëve
Të nderuar miq dhe mysafirë
Të nderuar qytetarë të Kosovës
Zonja dhe zotërinj*

Në hapje të kësaj seance solemne të Kuvendit, për nder të përvjetorit të gjashtë të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, më lejoni t'ju drejtohem me disa fjalë rasti.

Data e 17 shkurtit 2008 do të mbetet përjetësisht në historinë e Kosovës, si kurorë e përpjekjeve shekullore të popullit tonë për liri, pavarësi, demokraci dhe dinjitet njerëzor. Shpallja e Pavarësisë ishte akt historik, por të cilit i ka paraprirë një proces i gjatë çlirimtar, i mbuluar me lavdi, me gjak e sakrifica të panumërta, i ka paraprirë një luftë titanike për jetë a vdekje, që simbolizohet me emrin emblemë të komandantit legjendar, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari. Sot Kosova përulet me pietet para kujtimit dhe veprave të pashlyeshme të brezave të tërë që u shkrinë për atdheun e tyre, për lirinë dhe përparimin e tij.

Drejhtësia e qështjes së Kosovës, mbrojtja e vlerave demokratike botërore dhe e të drejtave njerëzore e bëri një forcën e bashkuar të miqve tanë, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të Bashkimit Evropian e të NATO-s, e cila iu gjet përkrah Kosovës së sflitur në çastet më të rënda historike. Në këtë ditë solemne, ne u drejtojmë atyre mirënjohjen tonë të thellë, bashkë me zotimin e vendosur për miqësinë dhe bashkëpunimin tonë të përkushtuar.

Gjashtë vjet të pavarësisë, Kosovën e kanë konfirmuar si vend i transformimeve dhe zhvillimit, si atdhe të qytetarëve të barabartë, si faktor kredibil paqe ndërtes dhe bashkëpunues me demokracitë përreth dhe kudo në botë. Kosova e pavarur për gjashtë vjet rresht, nuk e ka rrezikuar as dëmtuar askënd, sepse ajo si projekt dhe realitet është mbështetur dhe themeluar mbi



vlerat e larta të demokracisë moderne amerikane e euro-perëndimore. Në Kosovë është vendosur rend kushtetues që bazohet në parimet e lirisë, paqes e demokracisë.

Zonja dhe zotërinj

Republika jonë e re ka moshën e një fëmije që sapo fillon shkollën dhe mësimin. Para saj shpërfaqet në horizontin e kaltër e ardhmja plot sfida, por e sigurt. Ne kemi nevojë të mësojmë nga shembujt e mirë, por edhe të këqij, të të tjerëve, kemi nevojë të mësojmë të kaluarën për të mos na u përsëritur historia, as si farsë as si tragjedi, kemi nevojë të mbajmë gjallë amanetin e themeluesve të pavarësisë së Kosovës, për lirinë, për nderin dhe begatinë e vendit e popullit që përfaqësojmë. Vendi ynë, ka hyrë tashmë në projektin e madh dhe historik të integritimeve euroatlantike. Përcaktimi i popullit të Kosovës për vlerat evropiane dhe euroatlantike është baza dhe garancia e këtij projekti. Procesi reformues, shpesh herë me dhembje dhe kosto të lartë, lufta e pakompromis kundër krimit e korrupsionit dhe sigurimi i sundimit të ligjit e rendit, ngritja ekonomike dhe luftimi i varfërisë e papunësisë, janë padyshim, sfidat më të rënda të Kosovës në rrugën drejt së ardhmes së aspiruar.

Zonja dhe zotërinj

Kosova do t'u qëndrojë besnike vlerave mbi të cilat është themeluar si shtet dhe demokraci, do t'i qëndrojë besnike vetvetes, por edhe miqve të saj, duke qenë në partneritet të plotë me ta në synimin për një shoqëri dhe shtet modern, demokratik e paqësor, të anëtarësuar në OKB e në organizma tjerë ndërkombëtarë.
Faleminderit.



Pamje nga salla





Pamje nga sala



Fjala e kryeministrit Thaçi, në Kuvendin e Republikës së Kosovës me rastin e shënimit të gjashtë vjetorit të Ditës së Pavarësisë



*E nderuara presidente e Republikës së Kosovës, zonja Jahjaga;
I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës, z. Krasniqi;
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës;
Të nderuar ambasadorë dhe mysafirë të pranishëm;
Të nderuar qytetarë të Kosovës;
Zonja dhe Zotërinj;*

Jemi mbledhur sot këtu së bashku për të festuar ditëlindjen e Kosovës dhe unë dëshiroj t'ju përcjell juve dhe çdo qytetari të Kosovës, urimet më të përzemërta për përvjetorin e gjashtë të pavarësisë! Po në këtë sallë, gjashtë vjet më parë ne bashkërisht kemi finalizuar aspiratat dhe përpjekjet e shumë gjeneratave që na kanë paraprirë në rrugën tonë të gjatë. Ne kemi vënë në jetë ëndrrat e një populli të tërë për liri duke finalizuar një luftë të gjatë e të mundimshme për pavarësi. Prandaj sot kujtojmë me respekt të madh luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kujtojmë dhe respektoj sakrificën e të gjithë qytetarëve të Kosovës, për liri. Kudo që ishin, në Kosovë e diasporë. Kujtojmë punën e presidentit Rugova, kujtojmë heroizmin e pashoq të komandantit legjendar Adem Jashari, të komandantit Zahir Pajaziti, Shkëlzen e Luan Haradinaj, Fehmi dhe Xhevë Lladrofi, Agim Ramadani, Sali Çeku, Ilaz Kodrës dhe shumë e shumë heronjve tjerë që e vulosën lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Në këtë ditë të shenjtë, unë bashkë me ju dhe gjithë qytetarët e Kosovës shprehim nderimet dhe mirënjohjen më të lartë, përkulemi me nderë përpara veprës së

dëshmorëve që kanë dhënë jetën për të mundësuar këto ditë të lirisë e pavarësisë që gëzojmë sot. Kjo është padyshim një ditë gëzimi dhe lumturie për ne. Por gjatë festimit të pavarësisë ne ndiejmë gjithashtu dhimbje në zemrat tona për motrat e vëllezërit tanë të rënë apo të zhdukur që kanë punuar për këtë realitet të sotshëm që po jetojmë, por fatkeqësisht nuk janë mes nesh. Mirëpo, ne kemi dëshmuar se dimë ta kthejmë dhimbjen në forcë. Nuk jemi zhytur në depresion prej pikëllimit, por kemi ditur të ngrihemi në këmbë e të marrim vetë në duar fatet e vendit tonë. Përfitoj gjithashtu nga ky rast për të shprehur mirënjohjen e thellë si kryeministër i Republikës së Kosovës dhe në emër të qytetarëve të Kosovës dua të falënderoj Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Francën, Italinë dhe të gjitha shtetet aleate perëndimore të cilat besuan në kauzën tonë të drejtë dhe na ndihmuan për të siguruar lirinë e pavarësinë.

Një mirënjohje e veçantë shkon për shtetin shqiptarë, për kontributin që ka dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Unë edhe sot, dua ti siguroj aleatët tanë se tek Kosova kanë për të gjetur një mik mirënjohës dhe një besnikëri të përhershme e të pakushtëzuar. Faleminderit shumë! Falënderim për Shtete e Bashkuara të Amerikës për vendet e Bashkimit Evropian dhe NATO-n.

Të nderuar pjesëmarrës, 15 vite liri e 6 vjet pavarësi nuk janë shumë për historinë e një popullit por ne gjithsesi kemi bërë shumë në kaq pak kohë.

Në një kohë rekord ne ndërtuam nga zero institucionet shtetërore, organet e sigurisë dhe drejtësisë, dhe shërbimin diplomatik. Mandej me një proces të lodhshëm të dialogut me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe përkrahjen e fuqishme të SHBA-ve, arritëm marrëveshjen e parë historike për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Nëpërmjet kësaj marrëveshje, ne arritëm të sigurojmë respektimin e sovranitetit tonë shtetëror, rendit kushtetues dhe ligjeve tona, në gjithë territorin e Kosovës.

Si rezultat, kemi zhbërë strukturat ilegale në veri të vendit, kemi filluar procesin e integritit në institucionet legale të Kosovës, kemi mbajtur zgjedhjet e para lokale demokratike në tërë territorin e vendit, dhe i kemi dhënë fund anarkisë atje duke e shtrirë sundimin e rëndit dhe ligjit. Ne të gjithë duhet të ndihemi krenarë sepse sfidat me të cilat është përballur vendi ynë janë të jashtëzakonshme dhe të pakrahasueshme.

*Të nderuar deputetë;
Qytetarë të Kosovës;*

Vizioni i Kosovës së pavarur është ai i një shteti demokratik dhe të zhvilluar. Një Kosovë që është e bashkuar pavarësisht prej ndasive të opinionit, bindjeve apo përkatësisë etnike apo fetare. Një Kosovë që është e gatshme ta merr vendin që i takon në familjen e shteteve të lira të botës, që jeton në paqe me të gjithë fqinjët e saj dhe që përmbush me përgjegjshmëri obligimet ligjore dhe morale në arenën ndërkombëtare. Ne duhet të vazhdojmë të punojmë për të ndërtuar një Kosovë ku puna, iniciativa individuale, talenti, kreativiteti, këmbëngulja e çdo individi respektohet dhe shpërblehet. Një Kosovë ku sundon ligji, ku mbrohet prona private e kontratat, ku inkurajohen iniciativat private dhe garantohet konkurrenca e lirë e mundësitë e barabarta. Një vend ku shtresat sociale trajtohen me dinjitet në mënyrë që asnjë mos të ngelet jashtë përfitimeve që vijnë prej progresit dhe zhvillimit të shoqërisë sonë.

Një Kosovë ku çdo qytetar të mund të jetojë me dinjitet, respekt për vetveten, me shpresë e mirëqenie.

Ne që kemi jetuar për dekada të tëra në

robëri, e dimë sa e shtrenjtë është liria, e prandaj do bëjmë çmos që të punojmë që kosovari i thjeshtë të gëzojë maksimumin e lirive individuale në çdo fushë.

Pasi fituam lirinë politike do të punojmë pa pushim për rritjen e lirisë ekonomike, për garantimin e të gjitha lirive dhe të drejtave të njeriut si dhe zbatimin shembullor të të drejtave të pakicave.

Ne kemi bërë shumë përpjekje për ta përkthyer këtë vizion në realitet nëpërmjet nismave legislative, reformave, politikave apo programeve të ndryshme qeveritare dhe sot kam të drejtë të them se jemi duke ecur në drejtimin e drejtë. Ne të gjithë duhet të kontribuojmë për shtëpinë tonë dhe mënyrën se si ajo shihet në botë.

Përmirësimi i imazhit të vendit tonë është vendimtar jo vetëm për përpjekjet tona diplomatike për ta futur Kosovën në Organizatën e Kombeve të Bashkuara por edhe për zhvillimin ekonomik.

Duhet ti tregojmë mbarë botës se Kosova ka akomoduar plotësisht sipas standardeve më të larta të gjitha komunitetet pakicë që jetojnë në Kosovë, e në veçanti komunitetin serbë duke garantuar stabilitetin e brendshëm të vendit dhe kemi arritur marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve tona me Serbinë.

*Të nderuar deputet,
Të nderuar qytetarë të Kosovës,
Mysafir të nderuar,*

Pas zgjedhjeve dinjitoze lokale të vitit të shkuar ne po dëshmojmë se demokracia jonë funksionon në mënyrë normale. Kjo dëshmon se ne e kemi merituar besimin e dhënë nga partnerët tanë ndërkombëtar.

Më lejoni ta mbyll duke ju thënë se shumë sfida të mëdha ende ngelen para nesh dhe ne të gjithë së bashku duhet të jemi të përgatitur për të bërë përpjekjet dhe sakrificat e duhura për t'i kaluar ato. Megjithatë unë jam i bindur se ne do t'i kapërcejmë këto sfida pasi kemi dëshmuar se kemi kapërçyer sfida edhe më të mëdha në një të kaluar jo dhe aq të largët. Prandaj të nderuar deputetë, bashkëqytetarë të mi kudo që jeni, gëzuar Ditën e Pavarësisë dhe Zoti e bekoftë Kosovën dhe qytetarët e saj.

Faleminderit!



KUVENDI
REPUBLIKA E SHQIPERISE



Kryetari Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Ilir Meta, uron kryetarin e Kuvendit të Kosovës z. Jakup Krasniqi me rastin e 6 vjetorit të pavarësisë



I nderuar zoti Kryetar,

Kam kënaqësinë e thellë t'Ju përcjell Juve dhe nëpërmjet Jush, gjithë qytetarëve të Kosovës, urimet më të nxehta për Përvjetorin e Gjashtë të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Në këtë Ditë të shënuar Ju dhe të gjithë ne shqiptarët, kujtojmë me respekt dhe mirënjohje të thellë Martirët e Lirisë dhe gjithë ata punëtorë të mendjes dhe të armës që mundësuan Shpalljen e Pavarësisë.

Kujtojmë Presidentin Ibrahim Rugova, luftëtarin Adem Jashari, epopenë e heronjve të UÇK-së dhe gjithë ato vuajtje dhe sakrifica sublime të të gjithë qytetarëve të Kosovës në rrugëtimin e mundimshëm drejt Lirisë dhe Pavarësisë.

Një mirënjohje e veçantë për aktorët e mëdhenj të skenës politike botërore, për Shtetet e Bashkuara të Amerikës e Britaninë e Madhe, Bashkimin Evropian dhe NATO-n, pa të cilët, projekti evropian i Kosovës të lirë dhe evropiane nuk do të ishte i mundur.

Kosova ishte djepi i dhembjes së madhe, ishte vendi që u përball me krimet më të egra të pas Luftës së Dytë Botërore, por kjo është një arsye më shumë, që ajo sot dhe nesër të jetë një shtet evropian, ku shenjtërimi i të drejtave njerëzore, demokracia, sundimi i ligjit dhe bashkëjetesa mes etnive të ndryshme, të jenë në shkallën më të lartë.

Shpreh bindjen se marrëdhëniet mes dy vendeve tona do të vazhdojnë të jenë intensive, në interes reciprok dhe të paqes dhe sigurisë së të gjithë rajonit.

KOSOVA! - PA U NDALUR DREJT ZHVILLIMIT

Metamerfoza e ndryshimit

Në këtë përvjetor të 6-të, Kosova vjen me një transformim të jashtëzakonshëm ndryshimesh politike social-ekonomike dhe shoqërore.

Brenda 15 vjetësh, kur Kosova ishte kthyer në një gërmadhë nga shkatërrimi i një lufte genocidiale të pashoqe dhe para 6 vjetësh kur shpallep pavarësinë, Kosova ka bërë transformime të thella të pa imagjinueshme duke ndërtuar të gjitha institucionet shtetërore dhe funksionon si shtet i pavarur brenda kornizës së vet kushtetuese.

Nën drejtimin dhe bashkëpunimin e SHBA-ve dhe BE-së, kemi ndërtuar të gjithë së bashku një shtet demokratik, ku mbizotërojnë dhe funksionojnë të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut, të të gjitha komuniteteve pa dallim.

Kosova është kthyer në një shtet, që gjithnjë e me shumë po luan një rol të rëndësishëm në vendosjen e paqes në rajonin tonë në Ballkan e më gjerë.

Kemi bërë transformime të thella ekonomike dhe jemi duke e përmirësuar gjithnjë e më shumë imazhin tonë, e megjithatë kemi përpara vetes tonë sfida akoma të mëdha.

Por Kosova po kryen një nga sfidat më të mëdha, të cilën bota nuk mund ta imagjinonte dhe besonte dot.

E kjo është sfida e vendosjes së marrëdhënieve shtetërore me Serbinë.

Të ndërtosh institucione dhe të vendosësh ligje, të rindërtosh dhe ndërtosh ekonominë e vendit tënd të shkatërruar, është vërtetë një sfidë, por të ndërtosh urat e miqësisë dhe të falësh nga dhimbja jote e thellë është sfidë përmbi sfidë. E këtë në jetë e kanë bërë dhe po e bëjnë ne, populli i Kosovës.


Kjo është metamorfoza jonë e ndryshimit. Pikërisht për këtë Kosova po merr vlerësimet më të larta nga bota e zhvilluar moderne. Ne po i tregojmë botës se jemi një popull i lashtë fisnik me tradita dhe vlera të larta morale shoqërore.

Të falësh nuk është frikë, përrulje, por është fisnikëri.

E fisnikëria nuk dhurohet, por trashëgohet.



KOSOVA! - PA U NDALUR DREJT ZHVILLIMIT



FALENDERIM PËR KONTRIBUTIN TUAJ

SH
B
A



N
A
T
O



B
E



NDERIM PËR TË GJITHË JU



FALENDERIM PËR KONTRIBUTIN TUAJ



**german
cooperation**
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Deklarime të kryetarëve të grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës me rastin e 6 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës

ADEM GRABOVCI - PDK



Grupi Parlamentar i PDK-së, ka udhëhequr në këto 6 vite të pavarësisë me shumicën parlamentare në Kuvendin e Kosovës . Duke qenë grupi më i madh parlamentar ka arritur me përkushtim te krijojë unitet politik në shumë procese të shtet ndërtimit duke përfshirë gjithë partnerët ndërkombëtarë, partnerët qeverisës, si dhe me opozitën parlamentare.

Viti i gjashtë i pavarësisë, e gjen Kosovën më të konsoliduar se asnjëherë më parë, e gjen faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon, e gjen më të përkushtuar në zhvillim ekonomik dhe më të prosperuar drejt NATO-s dhe BE-së.

Për gjashtë vite të Pavarësisë, Kosova ka ndërtuar institucionet e saja shtet formuese dhe po ecën e sigurt drejt integriteteve euroatlantike.

Institucionet e Republikës së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Presidenca, Qeveria e Republikës së Kosovës, dhe gjyqësori kanë bërë një punë të madhe gjatë gjithë periudhës 6 vjeçare për ndërtimin forcimin dhe konsolidimin e të gjitha institucioneve të shtetit të pavarur dhe sovran të Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Kosovës ka përmbyllur me sukses fazën tranzitore të ligjeve, e cila ka kulmuar me përmbyllje të suksesshme të Pavarësisë së Kosovës. Pa angazhimin e mirëfillt të Qeverisë së Republikës së Kosovës në përmbyllje të kriteve të dala nga Pakoja e Ahtisarit, nuk do të kishim edhe përmbyllje të suksesshme të pavarësisë së mbikëqyrur.

Përkushtimi ynë për një shtet demokratik ligjor dhe për një ambient të sigurt, ku qytetarët e Republikës së Kosovës do të ndihen krenar për vendin e tyre do të jete gjithmonë.

ISMET BEQIRI - LDK



Nuk ka dyshim se Shpallja e Pavarësisë së Kosovës, me 17 shkurt 2008, është ngjarja më historike për qytetarët e Kosovës. Është realizimi i aspiratës shekullore për Liri, Pavarësi dhe Demokraci, ashtu siç e thoshte Presidenti historik i Kosovës Dr. Ibrahim Rugova.

Në 6 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, ne nuk mund t'i gëzohemi gjendjes aktuale të vendit tonë, të qytetareve tanë. Fatkeqësisht ky 6 vjetor po e gjen Kosovën me një; - keq qeverisje nga Qeveria aktuale, - mungesë të zhvillimit ekonomik, - mungese të sundimit të ligjit, -shkallë të lartë të korrupsionit. Qytetarët tanë nuk mund te lëvizin lirshëm si çdo qytetar tjetër i lirë i Evropës.

Liria e Kosovës nuk është arritje e asnjë personi apo udhëheqësi të vetëm, por vepër e shumë brezave që luftuan dhe u sakrifkuan për këto ideale të mëdha, të cilat tani duhet të na frymëzojnë ne për realizimin e pjesës së mbetur.

Kosovës i duhen ndryshime për të mirën e Qytetareve të saj. Besimi se të gjithë brenda Kosovës ndajmë të njëjtin fat, e ka mbushur LDK-në me kaq shumë shpresë dhe gjithmonë ka besuar, se shpresa është gjëja më kokëforte brenda saj dhe ndaj këmbëngul, se me gjithë provat e shumta për të kundërtën, diçka më e mirë na pret, për sa kohë kemi kurajën ta kërkojmë, të punojmë për të dhe të luftojmë për të.

Le të shpresojmë që ndryshimi do të ndodhë në këtë vit zgjedhor, me fitoren e LDK-se dhe instalimin e një mirëqeverisje në vend.

Visar Ymeri , VV



Shpallja e Pavarësisë së Kosovës, me 17 shkurt 2008, gjashtë vite pas, e gjen vendin ende nën dy procese negative: Dialogu në mes Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Serbisë dhe privatizimi i ndërmarrjeve publike të Kosovës.

Marrëveshja e 19 prillit ndërmjet Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës Thaçi dhe e atij të Serbisë, Ivica Daçiç, e ka kthyer Kosovën, para shpalljes së Pavarësisë. Lëvizja VETËVENDOSJE! është munduar, si në Kuvend, si në emisione televizive dhe debate të tjera, t'i bëjë të qarta dëmet e mëdha që kjo marrëveshje po i sjell vendit, para se të provojmë ta ndalojmë atë. Kjo marrëveshje e ka zbehur shtet ndërtimin politik dhe institucional, duke ja hequr logon Republikës së Kosovës nga dokumentet zyrtare, emërimi i Nenad Gjuriçit për komandant rajonal, i cili ka qenë një ish-polit i Millosheviçit, si dhe zgjedhjet lokale, të cilat u shpallën nga Ivica Daçiç, ende pa u shpallur nga institucionet e Kosovës.

Kjo marrëveshje e nënshkruar, e ratifikuar një anshëm nga Kuvendi i Kosovës, me presionin më të madh të mundshëm, ka sjell pasojat e veta ligjore për shtetin e Kosovës. Janë dy elemente negative që prej marrëveshjes derivojnë. Ligji për amnisti, që amnistion një grup shoqëror, e liron atë përveç nga ndjekja penale edhe nga hetimi, si dhe rishikimi i buxhetit për ta akomoduar të ashtuquajturin Fondin Zhvillimor për Veriun. Ky buxhet ka për synim të financojë Asociacionin e komunave serbe, e duke e varfëruar edhe më tepër buxhetin e varfër të Kosovës.

Nëse do ta kishim zbrëthyer këtë marrëveshje atëherë ajo do të ishte bashkëpjesëmarrje në aktivitetet e Serbisë që kanë për qëllim minimin e mundësisë së ndërtimit të Republikës sovraane të Kosovës. As procesi e as marrëveshja e parë në këtë proces negociatash, nuk janë normalizim i marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë, por ri definim i strukturës së brendshme institucionale, territoriale e të financave publike të Kosovës, për t'ua përshtatur atë kërkesave të Serbisë.

Gjashtë vite të pavarësisë së Kosovës janë përcjell edhe nën procesin e privatizimit dhe koncesionimit të Ndërmarrjeve Publike më të mëdha në vend. Qeveria e Kosovës në maj të vitit 2012, e shiti Distribucionin e KEK-ut për 26 milionë euro.

Po ashtu, tentimi i shitjes së 75 % të aksioneve të PTK-së, ka përbërë një rrezik të madh për shtetin e Kosovës. Qeveria është munduar disa herë që në Kuvend të Kosovës, të miratojë raportin përfundimtar e që do t'i jipte të drejtë Ministrit të Zhvillimit Ekonomik të nënshkruante kontratën me AXOS-in. Ky përfundim i qeverisë, për ta rritur ekonominë e vendit, duke e shitur një mbushës të përvitshëm të Buxhetit të Kosovës, ka dështuar dhe në këtë mënyrë është hapur një mundësi e re se çka do të ndodh në vitin 2014 me PTK-në.

Ardian Gjini, AAK



17 shkurti është dita e rumbullaksimit të synimit shekullor të Shqiptarëve të Kosovës për Liri dhe Pavarësi. Vetë shpallja e Pavarësisë si e tillë, nuk garanton jetë më të mirë dhe mirëqenie për qytetarët, duhet mund, punë e vazhdueshme dhe përkushtim. Pavarësia i krijon këto mundësi, por nuk është garanci në vetvete për ti arritur synimet individuale dhe kolektive. Me Pavarësinë marrim edhe obligim që këto synime ti arrijmë vet. Vendosija e Sundimi të ligjit, barazisë, lirisë individuale dhe mirëqenies është obligim i yni dhe arrihet me punë.

Myfera Shinik'6+''



Këto ditë do të festojmë përvjetorin e Pavarësisë, të cilën para gjashtë vitesh e pritëm me padurim.

Pas udhëtimit të gjatë, Kosova ia arriti të bëhet shtet sovran dhe i pavarur, çka edhe e ka merituar. Në këtë drejtim, me Kushtetutën dhe legjislacionin

e vet, i garanton të gjitha të drejtat dhe interesat e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Grupi parlamentar "6+" që përbëhet nga tre deputetë, përfaqësues nga radhët e komunitetit turk, dy deputetë, përfaqësues të komunitetit boshnjak, si dhe një deputetë, përfaqësuese i komunitetit rom, dëshmon se Kosova vërtetë është vend demokratik.

Meqë Kosova është një shtet i ri në botë dhe njëherit shteti më i ri i Evropës, ajo duhet të shpejtojë dhe ta ngritë bashkëpunimin me shtetet e rajonit, të cilat posedojnë veçori të përbashkëta historike, politike e kulturore. Posaçërisht mendoj se, respektimi i marrëdhënieve të mira ndërfqinjësore me shtetet fqinje, do të ndikojë në rritjen e numrit të shteteve që do ta njohin Kosovën.

Kur është fjala për njohjet, me qëllim të njohjes së Kosovës nga sa më shumë shtete, lobimi i Turqisë është shumë i rëndësishëm, duke u nisur edhe nga fakti se ajo është ndër të parat që e ka njohur shtetin e Kosovës.

Në të njëjtën kohë, si Grup i miqësisë në mes të Kosovës e Turqisë, në drejtim të zhvillimit të marrëdhënieve tona dypalëshe, duhet ta vazhdojmë punën tonë të përbashkët.

Ne si komunitet jemi të vendosur që, sikur më parë edhe tani, të vazhdojmë të ofrojmë përkrahjen dhe kontributin tonë që Kosova të ndërtohet, të zhvillohet dhe të radhitet ndër shtetet me rëndësi.

DIPLOMACIA PARLAMENTARE

Kryeparlamentari Krasniqi priti shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë, Samuel Zhbogar



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti sot në takim shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Samuel Zhbogar, me të cilin bisedoi për punën që e pret Kuvendin gjatë pjesës së parë të këtij viti dhe për një varg zhvillimesh të tjera. Pasi ka çmuar punën e Kuvendit gjatë vitit të kaluar, përfaqësuesi i BE-së e ka konsideruar vitin 2014 si mjaft të rëndësishëm për Kosovën dhe në këtë mes, ka piketuar edhe rolin që do të ketë Kuvendi. Reforma zgjedhore ishte një nga çështjet kryesore në të cilën ai u fokusua, duke vlerësuar që ndryshimet eventuale të ligjit të jenë në funksion të zgjedhjeve të lira e të ndershme.

Zhbogar shtroi nevojën që ligjet të cilat kanë të bëjnë me procesin e integritimit evropian të Kosovës, konkretisht me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, të jenë prioritet i punës së Kuvendit gjatë gjysmës së parë të këtij viti. Në këtë funksion, ai u ndal edhe në mundësitë e një koordinimi edhe më të ngushtë ndërmjet palëve.

Kryeparlamentari Krasniqi, pasi hodhi një vështrim mbi ecurinë e punës së Komisionit për reformën zgjedhore, tha se reforma varet nga subjektet politike dhe njëherësh shprehu skepticizmin e tij që ky proces mund të përfundojë para zgjedhjeve. Sa i përket miratimit të ligjeve, Krasniqi tha se Kuvendi do të përpikët ta kryejë funksionin e tij legjislativ konform nevojave të Kosovës dhe qytetarëve të saj, si në aspektin e brendshëm, ashtu edhe në atë që lidhet me procesin e integritimit evropian. Përkitazi me këtë, kryetari i Kuvendit shprehu gatishmërinë për ta thelluar koordinimin me mekanizmat e tjerë relevantë. Në takim u fol edhe për rishikimin strategjik të EULEX-it, i cili pritet të ndodhë gjatë muajve në vijim, si dhe për rolin që do ta ketë Kuvendi në këtë proces.

Kryeparlamentari Krasniqi priti shefin e ri të misionit të FMN-së në Kosovë, Jacques Alain-Miniane



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti sot në takim shefin e sapoemëruar të misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) në Kosovë, Jacques Alain-Miniane, me të cilin bisedoi për zhvillimet aktuale në vend, që lidhen me aspekte financiare. Në takim ishte i pranishëm edhe shefi i deritashëm i këtij misioni, Johannes Wiegand, i cili prezantoi pasardhësin e tij në krye të misionit të FMN-së dhe njëherësh, vlerësoi lart bashkëpunimin me Kuvendin gjatë periudhës sa ai ka udhëhequr këtë mision.

Jacques Alain-Miniane, ndërkaq, tha se do ta vazhdojë punën e z. Wiegand dhe shprehu interesimin për ta vazhduar bashkëpunimin me Kuvendin e Kosovës.

Kryetari Krasniqi falënderoi shefin në largim të misionit të FMN-së për bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e mira, ndërsa shefit të sapoemëruar i uroi suksese në detyrën e tij të re. Me këtë rast, Krasniqi shprehu gatishmërinë dhe interesimin për ta vazhduar bashkëpunimin, në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar të Kosovës dhe shpenzimeve adekuate të buxhetit të shtetit

Kryekuvendari Krasniqi u prit nga Presidenti i Shqipërisë Bujar Nishani dhe Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë Ilir Meta

Kryetari i Kuvendit të Kosovës , dr. Jakup Krasniqi, në kuadër të qëndrimit të tij në Tiranë, ku po merr pjesë në Forumin e 6-të publik, të organizuar nga Akademia Shqiptare e Arteve dhe Shkencave, u prit sot në takime të ndara nga presidenti i Shqipërisë, Bujar Nishani dhe kryetari i Parlamentit të Shqipërisë, Ilir Meta.

Gatishmëri e Shqipërisë
për të ndihmuar Kosovën në proceset drejt integritimeve evropiane.

Duke i uruar mirëseardhje kryekuvendarit Krasniqi, presidenti i Shqipërisë, Bujar Nishani, vlerësoi lart bashkëpunimin që po zhvillohet ndërmjet institucioneve të Shqipërisë dhe të Kosovës në të gjitha fushat. Presidenti Nishani u angazhua edhe për nevojën e zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve në lëmin ekonomik.



Është e nevojshme harmonizimi i termave juridike
në legjislacionin e të dy shteteve.



Kryekuvendari Krasniqi u prit në një takim edhe nga kryetari i Parlamentit të Shqipërisë, Ilir Meta. Në takim u theksuan rezultatet që po arrihen në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet dy parlamenteve, por edhe ndërmjet institucioneve tjera të Shqipërisë dhe Kosovës. Bashkëbiseduesit shtruan nevojën që të bëhet më shumë në harmonizimin e termave juridike në legjislacionin e të dy shteteve. Në të dy takimet u shfaq gatishmëria e Shqipërisë për të ndihmuar Kosovën në rrugëtimin e saj drejt integritimeve evropiane.

Kryekuvendari Krasniqi priti z. Christian Danielsson, drejtor gjeneral i Drejtoratit të Përgjithshëm për Zgjerim në KE



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti sot në një takim z. Christian Danielsson, drejtor gjeneral i Drejtoratit të Përgjithshëm për Zgjerim në Komisionin Evropian. Në këtë takim merrte pjesë edhe shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Samuel Zhbogar. Duke u falënderuar për pritjen, z. Christian Danielsson theksoi se është i impresionuar me të arriturat në Kosovë. Z. Christian Danielsson në vijim tregoi interesim edhe për realizimin e obligimeve të Kuvendit në aspektin e realizimit të Planit që del nga MSA-ja ndaj Kuvendit të Kosovës. Mirëpo, në proceset që po zhvillohen në Kosovë, ka mbetur gjithsesi akoma për t' u punuar sidomos në luftën kundër korrupsionit, kriminit të organizuar dhe dukurive të tjera negative, theksoi ai. Në këtë vështrim, shtrohen detyra edhe sa i përket qasjes ndaj zhvillimit më të hovshëm ekonomik. Kjo kërkon që të gjitha entitetet shtetërore të jenë në funksion të sfidave të gjithmbarshme që shtrohen para institucioneve dhe shoqërisë kosovare në tërësi. Komisioni Evropian do të ndihmojë Kosovën edhe sa i përket detyrave që dalin nga MSA-ja.

Kryekuvendari Krasniqi në fillim theksoi se sipas Planit të Veprimit për MSA-në nga Kuvendi kërkohet miratimi i 71 ligjeve, nga të cilat 27 ligje janë miratuar, në procedurë janë 14 , Qeverisë iu kanë kthyer 4, në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2014 të papërfshira janë 8 projektligje, ndërsa janë të përfshira në këtë plan 18 sosh. Obligimet e Kuvendit sipas Planit të veprimit të MSA-së janë pjesë e planit të punës së komisioneve të Kuvendit dhe pjesë e programit të punës së Kuvendit për këtë vit dhe do të kenë prioritet në realizimin e tyre. Në vijim z. Krasniqi bëri një vështrim punës së institucioneve të pavarura, si dhe zgjedhjeve në këto institucione. Aktualisht, tha ai, është në procedurë çështja e zgjedhjes së Avokatit të Popullit, të cilit i përfundon afati në qershor. Ky proces do të kryhet brenda afatit,

theksoi kryetari i Kuvendit. Në vijim kreu i legjislativit të vendit Krasniqi foli edhe për zgjedhjet në bordet e agjencive, si dhe në Gjykatën Kushtetuese, në të cilën duhet të zgjedhet një anëtar i ri vendës, meqë një vend është vakant, ndërsa së shpejti iu përfundon mandati edhe tre gjykatësve ndërkombëtarë në këtë Gjykatë.

Duke u përgjigjur në interesimet e mysafirëve rreth reformës zgjedhore, kreu i legjislativit të vendit , z. Krasniqi, theksoi se Parlamenti i Kosovës është i interesuar që me kohë të kryejë reformën zgjedhore, mirëpo ndikimet politike janë të mëdha në këtë segment. "Megjithëkëtë, jemi të interesuar që reforma zgjedhore të kryhet sa më shpejt, ndërsa tërë materiali i Komisionit had hoc për reformën zgjedhore tashmë iu ka dorëzuar Komisionit për Legjislacion, i cili do të bëjë Projektligjin për zgjedhjet", pohoi kryekuvendari Krasniqi. Duke u ndërlidhur me këtë çështje shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Samuel Zhbogar, shfaqti mendimin se në procesin e reformës zgjedhore më shumë bien në sy disa ndryshime teknike. Ndërsa, përmendi edhe problemet me listat e votuesve, në të cilat ka edhe emra të të vdekurve, duke kërkuar që ato të pastrohen.

Përkitazi me këto çështje, kryekuvendari Krasniqi tha se në zgjedhjet e kaluara problem kryesor ishte mbrojtja e votave të kandidatëve të partive politike, ndaj ekziston një interesim i madh që vota të mbrohet dhe të jetë tregues i vërtetë i vullnetit të qytetarëve. Ndërkaq, problem është edhe çështja e mundësisë së votimit për qytetarët tanë që jetojnë në shtete të ndryshme të Evropës, por edhe në SHBA.

Bashkëbiseduesit ishin unik në konstatimin se bashkëpunimi i deritashëm ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës është shumë i mirë. Nga ana e mysafirëve u shpreh gatishmëri e lartë e Komisioni Evropian për të ndihmuar Kosovën në të gjitha këto procese.

Kryekuvendari Krasniqi priti zëvendëskryeministrin e Malit të Zi, Igor Llukshiq

E Enjte, 27.02.2014

Një delegacion nga Mali i Zi, i kryesuar nga Igor Llukshiq, zëvendëskryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme dhe Integritimeve Evropiane u prit nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi. Kryekuvendari Krasniqi theksoi se marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi janë mjaft të mira, por ekzistojnë mundësi që këto marrëdhënie të avancohen edhe më tej. Në këtë frymë ekziston gatishmëri, për thellim të vazhdueshëm të bashkëpunimit, që vjen si obligim dhe vullnet, si nga fqinjësia e mirë, ashtu edhe nga fakti që në shtetet tona jetojnë përkatësisht komunitetet shqiptare dhe malazeze. Duke i bërë një vështrim të kaluarës së dy vendeve, z. Krasniqi theksoi se gjithnjë duhet të reflektojmë nga ajo që na bashkon edhe gjatë historisë, duke u angazhuar për një të ardhme më të mirë, jo vetëm ndërmjet dy shteteve, por edhe në tërë Rajonin. Në këtë aspekt, komunitetet pakicë asnjëherë nuk shikohen si pengesë, por si mundësi për bashkëpunim. Lidhur me çështjen e njohjes me kushtetutë të komunitetit malazias dhe të drejtës së tij për të pasur një vend në Kuvendin e Kosovës, të ngritur nga z. Llukshiq, kryekuvendari Krasniqi tha se kjo çështje do të zgjidhet me ndryshimet kushtetuese.

Në këtë kontekst, z. Llukshiq tha se shoqëria malazeze ka gatishmëri për realizimin e të drejtave për bashkësinë shqiptare në Mal të Zi.

Zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme dhe Integritimeve Evropiane, Igor Llukshiq theksoi se kjo vizitë është një kontribut për marrëdhënie edhe më të mira ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës. Për këtë duhet të kontribuojnë, posaçërisht dy qeveritë, duke bashkëpunuar në segmente të sendërtuara, që të jene në dobi të qytetarëve të të dyja shteteve. Bashkëbiseduesit ishin unik në vlerësimin se përpjekjet që bëhen nga dy shtetet drejt integritimit evropian dhe ndihma që mund të ofrohet në këtë shteg do të sjellin prosperitet dhe do të forcojnë bashkëpunimin e ndërsjellë.

Kryeparlamentari Krasniqi priti një delegacion nga Bundestagu gjerman

E Marte, 25.02.2014

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti një delegacion nga Bundestagu gjerman, të kryesuar nga deputeti Johannes Selle, me të cilin bisedoi për zhvillimet aktuale në Kosovë, perspektivën evropiane të saj, si dhe për bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve. Krye parlamentari Krasniqi i njoftoi parlamentarët gjermanë me proceset nëpër të cilat po kalon vendi ynë, duke i shpalosur edhe sfidat dhe vështirësitë me të cilat ai po përballet. Kryetari i Kuvendit u ndal te nevoja për liberalizimin sa më të shpejtë të vizave për qytetarët e Kosovës, si dhe për një zhvillim më të hovshëm ekonomik, i cili, siç tha Krasniqi, do të mundësonte krijimin e vendeve të punës, veçanërisht për të rinjtë. Z. Krasniqi kërkoi mbështetjen e mëtejshme të saj për tejkalimin e sfidave me të cilat po përballet vendi ynë.

Duke konfirmuar mbështetjen e Berlinit zyrtar për Kosovën edhe në të ardhmen, udhëheqësi i delegacionit gjerman, Johannes Selle, u fokusua te nevoja për investime në ekonomi dhe në krijimin e perspektivës për të rinjtë, si mundësi për tejkalimin e problemeve ekonomiko-sociale. Lidhur me këtë, ai kujtoi përvojën e Gjermanisë me pjesën lindore të saj, pas viteve të '90-ta.

GRUPI I GRAVE DEPUTETE

TAKIM - TRYEZË

Teuta Sahatçija - (GGD)



Liria dhe pavarësia e Kosovës është ngjarja më madhështore për popullin e Kosovës. Shpallja e Pavarësisë është realizim i ëndrrave dhe përpjekjeve të shumë gjeneratave të cilët dhanë gjakun djersën dhe u sakrifkuan për këtë ditë. Dhe gratë dhe vajzat e Kosovës të cilat kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për këtë ditë, fatkeqësisht janë shumë pak të vlerësuara. Tashmë që Kosova ka ndërtuar dhe po ndërton institucionet demokratike, ku liria dhe shanset e barabarta janë vlera bazë të ndërtimit dhe zhvillimit demokratik, ne gratë, krijuese të jetës, po marrim rol gjithnjë e më të fuqishëm që të jemi pjesë e pandarë e zhvillimit dhe mirëqenies tonë kombëtare. 6 vjetori i Shpalljes së Pavarësisë na obligon Ne, Grupi i Grave Deputete, të jemi të përkushtuara që me dinamikë akoma më të shtuar të rrisim fuqizimin e rolit të gruas, në të gjitha fushat e jetës, politikë, biznes, ekonomi, drejtësi, art kulturë, edukim etj. Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit (OZHM).si dhe objektivave që dalin nga Rezoluta për fuqizimin e Gruas” Parimet e Prishtinës” do të kthehen në kontributin e madh të proceseve për integrimin e Kosovës drejt BE-së.

GGD-ja në takimin “Gratë deputete 2001-2013”

Grupi i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës organizoi në hollin e Kuvendit takimin: "Gratë deputete 2001-2013", tema bosht e së cilës ishte historiku i zhvillimit të këtij grupi, roli i gruas në Parlamentin e Kosovës, si dhe Strategjia e GGD-ës. Me këtë rast grave deputete iu drejtua me një fjalë rasti, kryetari i Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi. Duke përshëndetur gratë deputete të të gjitha legjislativave, ai u shpreh: " Jam i vetëdijshëm se jo vetëm gruaja, por e gjithë shoqëria jonë në Kosovë ka nevojë për një emancipim të ri. Jam i bindur se gratë deputete, gratë e arsimuara të lëmenjve të ndryshëm, të artit, shkencës dhe kulturës, ato që kanë fatin të punojnë në arsim me gjeneratat e reja dhe të gjithë së bashku, e kemi një obligim të shenjtë për të dhënë kontributin tonë në edukimin e brezave, në mënyrë që të eliminohen të gjitha barrierat që i ka vendosur e kaluara mes gjinive, por edhe në mes nacionaliteteve të ndryshme në hapësirën tonë jetësore. Natyrisht, përkushtimi më i madh duhet të jetë në kuadër të Kuvendit të Kosovës, si institucioni më i lartë legjislativ i Republikës së Kosovës, por unë e përshëndes angazhimin e grave deputete, të organizuar në këtë nivel dhe i uroj për të gjitha sukseset që kanë arritur në këtë drejtim, duke u bërë edhe shembull i mirë i punës së tyre për t' u ndjekur edhe nga vende dhe parlamenteve të ndryshme". Grave deputete pastaj iu drejtua kryetarja e Grupit të Grave Deputete, Teuta Sahatçija, e cila gjerësisht foli për rrugën e formimit të Grupit të Grave Deputete. Duke rreshtuar sukseset që ka arritur ky grup, ajo përmendi veçanërisht aprovimin e Ligjit të Barazisë Gjinore, i cili u hartua nga ana e

Komisionit për Barazinë Gjinore, ndërsa u miratua nga ana e Kuvendit të Kosovës. Në vijim ajo foli edhe për një varg të gjatë të aktiviteteve nga më të ndryshme të këtij grupi, që bëhen për afirmimin dhe fuqizimin e pozitës së gruas në të gjitha segmentet e shoqërisë sonë. Ajo i bëri edhe një prezantim strategjisë së punës së këtij grupi në të ardhmen.

Në këtë takim për kontribut të jashtëzakonshëm në themelimin dhe punën e deritashme u dhanë shumë mirënjohje dhe falënderime. Mirënjohja e parë i takoi ish-sekretares së shtetit të SHBA-së, Medlin Ollbrajt, e cila personalisht ndihmoi formimin e këtij grupi të deputeteve. Në emër të z. Ollbrajt, mirënjohjen e mori , ambasadorja e SHBA-së në Kosovë, Trejsi Jakobson. Ajo tha se është kënaqësi që merr këtë mirënjohje për z. Ollbrajt. Në vijim ajo tha se Kosova po arrin suksese të mëdha, ndërsa me përpjekje të përbashkëta Kosova do të zhvillohet edhe më. Mirënjohje iu nda , pas vdekjes, edhe heroinës së Kosovës, Xhevë Lladrovci.

Tryezë për Ligjin e punës dhe nivelin e zbatueshmërisë së këtij ligji

Grupi i Grave Deputete (GGD), në bashkëpunim me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, ka mbajtur sot një tryezë me temën: Ligji i Punës dhe niveli i zbatueshmërisë së tij.

Fillimisht kryetarja e GGD-së, Teuta Sahatqija, gjatë diskutimit lidhur me këtë çështje tha se Ligji i Punës është njëri nga ligjet që më së shumti është i lidhur me jetën dhe mirëqenien e qytetarëve. Ajo sqaroi se GGD-ja ka qenë shumë aktive edhe gjatë draftimit të këtij ligji në Kuvendin e

Republikës së Kosovës, deri në miratim. Megjithatë, shtoi Sahatqija GGD-ja ka pasur vëmendje që në vazhdimësi ta përcjellë nivelin e zbatueshmërisë së këtij ligji. Ajo tha se edhe pse komisioni kompetent ka qenë mjaft i angazhuar lidhur me këtë ligj, GGD-ja konform objektivave të veta për promovimin e politikave afirmative drejt barazisë gjinore ka bërë mbikëqyrjen e Ligjit të Punës, me fokus në aspektin gjinor. Sahatqia tha se duhet të kemi vëmendje të posaçme veç tjerash edhe sa i përket kontratave të punës, pushimit mjekësor, vjetor dhe atyre të festave, si dhe mbrojtjes në punë dhe kompensimeve.

Ndërkaq, ministri i MPMS-së, Nenad Rashiq, tha se për zbatimin e Ligjit të punës është e rëndësishme që të eliminohet informaliteti në ekonomi, dhe sipas tij atëherë punëtorët do t'i gëzonin të drejtat e tyre konform ligjit.

Tutje, foli edhe Shukrie Rexhepi, nga BSPK-ja. Ajo theksoi se Ligji i Punës duhet të jetë më i favorshëm për punëmarrësin sa i përket kontratave të punës, pushimit mjekësor, punës jashtë orarit etj. Kurse, zëvendëskryetarja e komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Time Kadriaaj, tha se meqë ka një mori çështjesh që duhet rregulluar, Ligji i Punës duhet të shkojë në plotësim ndryshim. Ndërsa, Lumnie Hashani nga OEK-u paraqiti qëndrimet e bizneseve private lidhur me pushimin e lehonisë. Deputetja Blerta Deliu-Kodra vëri në theks edhe çështjen e sigurisë në punë. Në tryezë kontribuan edhe pjesëmarrës të tjerë.

Krejtësisht në fund, u dhanë rekomandimet të cilat do të përfshihen me rastin e plotësim-ndryshimit të këtij ligji.

VËSHTRIM HISTORIK MBI TERRORIZMIN DHE AKTET TERRORISTE

Terrorizmi dhe aktet terroriste nuk janë dukuri vetëm të botës së sotme moderne. Mund të thuhet se sot dukuritë terroriste janë zhvilluar duke u bërë kërcënim real për botën moderne dhe qeveritë demokratike. Veprat terroriste kanë ekzistuar në forma nga më të ndryshmet duke përfshirë edhe ato më primitivet, duke pasur parasysh që zanafillën e tyre e kanë që prej kohëve më të lashta të njerëzimit. Terrorizmi është një dukuri dinamike që ka evoluar me zhvillimet dhe arritjet e shkencës dhe të njerëzimit në tërësi.

Ai nuk ka mbetur statik, por ka përqaftuar gjithnjë përsosmërinë e teknologjisë së re, për të arritur qëllimet e tij. Aktet terroriste, sipas kuptimit që kanë sot, kanë ekzistuar në të vërtetë që në fazat e hershme të zhvillimit të shoqërisë. Më pas terrorizmi ka evoluar nëpër vite, për të marrë formën e kohës së sotme.

Format e para të akteve terroriste ndeshen që në disa fise të lashta të quajtura Zealots dhe Sicarii, të cilat datojnë në shekullin e I p.e.s. Më saktësisht terrorizmi i ka gjurmët rreth 2000 vjet më parë. Zealots² dhe Sicarii³ ishin fise çifute që jetonin në Lindjen e Mesme gjatë kohës së okupimit romak. Pasues të tjerë të këtyre fiseve terroriste ishin edhe ata të quajtur Assassinët që datojnë në shekullin e 11-të të cilët përdornin metoda të tilla që përbëjnë format e terrorizmit të sotëm. Ashtu si edhe Zealots-Sicarii, Assassinët, ishin grupe fetare, të cilët quheshin edhe Ismailët dhe sulmonin politikanët, njerëzit e fesë dhe njerëz të tjerë, të cilët nuk ndiqnin ose nuk adoptonin praktikat e rregullta fetare të Islamit.

Të fillosh të përshkruash historinë e

terrorizmit, pa patur ende një përkufizim të tij të saktë, mund të duket paksa e pakuptimtë, por sot, ende nuk ka një përkufizim unik për terrorizmin. Terrorizmi nuk është një dukuri e re. Për më tepër ai nuk ka mbetur një dukuri statik. Ai ka evoluar nëpër vite duke u shfaqur në format e sotme moderne. Terrorizmi më parë praktikohet për bindje fetare, ndërsa sot përveç bindjeve fetare aktet terroriste kryhen edhe për qëllime politike. Autorë të ndryshëm janë përpjekur ta shpjegojnë dukurinë e terrorizmit. Kështu, Paul R. Pillar thekson “ Terrorizmi është një sfidë e cila duhet të menaxhohet dhe jo të zgjidhet ”. Të tjera të dhëna flasin edhe për forma të terrorizmit të shfaqura gjatë periudhës së Revolucionit Francez.

Termi terrorizëm vjen nga shprehja “regime de la terreur”, që zotëroi në Francë në vitet 1793-1794.

Fillimisht terrori ishte instrument i shtetit dhe përdorej për të konsoliduar fuqinë e regjimit revolucionar të Qeverisë.

Terrori përdorej për të mbrojtur Qeverinë nga të gjithë elementet që konsideroheshin diversioniste dhe kërkonin përmbysjen e saj. Pra, fillimisht gjatë kësaj kohe të regjimit në Francë, terrorizmi përdorej në kuptimin e tij pozitiv. Udhëheqësi i Revolucionit Francez Maximillien Robespierre e shihte terrorizmin si vital për mbrojtjen e Qeverisë së sapokrijuar, duke shpallur më 1794 që “Terrori nuk është gjë tjetër veç drejtësi, manifestim i virtytit, mjet në funksion të parimit të përgjithshëm të demokracisë, i zbatuar në vendin tonë për nevojat më urgjente.”

Terrorizmi e mori kuptimin negativ që mbart sot edhe nga shkrimet e disa politologëve si



anglezi Edmund Burke, filozof politik, i cili e popullarizoi termin terrorist në anglisht, duke dënuar revolucionarët francezë. Shfaqja e ideologjisë politike si ajo e marksizmit, gjithashtu, krijoi një sens produktiv të paqëndrueshmërisë së rregullit ekzistues, duke e përcaktuar terrorizmin si një mjet për ndryshim.

Terrori përdorej për të mbrojtur Qeverinë nga të gjithë elementet që konsideroheshin diversioniste dhe kërkonin përmbysjen e saj. Pra, fillimisht gjatë kësaj kohe të regjimit në Francë, terrorizmi përdorej në kuptimin e tij pozitiv. Udhëheqësi i Revolucionit Francez Maximilien Robespierre e shihte terrorizmin si vital për mbrojtjen e Qeverisë së sapokrijuar, duke shpallur më 1794 që “Terrori nuk është gjë tjetër veç drejtësi, manifestim i virtytit, mjet në funksion të parimit të përgjithshëm të demokracisë, i zbatuar në vendin tonë për nevojat më urgjente.”

Terrorizmi e mori kuptimin negativ që mbart sot edhe nga shkrimet e disa politologëve si anglezi Edmund Burke, filozof politik, i cili e popullarizoi termin terrorist në anglisht, duke dënuar revolucionarët francezë. Shfaqja e ideologjisë politike si ajo e marksizmit, gjithashtu, krijoi një sens produktiv të paqëndrueshmërisë së rregullit ekzistues, duke e përcaktuar terrorizmin si një mjet për ndryshim.

Revolucionari Italian Carlo Pisane, i cili e njihte përdorimin e terrorizmit, për të shpërndarë një mesazh audiencës ndryshe nga ai i përcaktuar dhe të tërhiqte vëmendjen te një qëllim – duke e përcaktuar këtë si një formë të re të terrorizmit. Teza e Pisane-s, e cila nuk ishte e re, por njihej

edhe nga Zealots - Sicari dhe Assasin-sit, – u vendos fillimisht në praktikë nga Narodnaya Volya, një grup popullor rus i krijuar më 1878 për të kundërshtuar regjimin Carist. Ngjarja më e madhe e grupit ishte vrasja e Aleksandrit II më 1881, njëkohësisht edhe përmbysja e regjimit carist. Grupe nacionaliste si ato në Irlandë ose në Ballkan e adoptuan terrorizmin si një mjet për të arritur dëshirat dhe qëllimet e tyre përfundimtare.

Përpara mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, në Europë kishte filluar të manifestohej ajo që më vonë u quajt “terrorizëm i financuar nga shteti”. Kështu, shumë zyrtarë në Qeverinë dhe ushtrinë serbe ishin përfshirë në mbështetjen, trajnimin dhe pajisjen me armë të grupeve të shumta në Ballkan, të cilat ishin aktive në vrasjen e Archduke Franz Ferdinand më 1914 në Sarajevë. Në vitet 1930 u pa një valë e re vrasjesh politike, meritat e të cilave i korrespondojnë fjalës terrorizëm. Kjo çoi në shfaqjen e propozimeve të disa shteteve në hartimin e konventave, për të parandaluar dhe dënuar terrorizmin, si dhe krijimin e një gjykate ndërkombëtare penale. Pavarësisht kësaj, gjatë kohës midis dy luftërave terrorizmi i referohej masave të ashpra që imponoheshin nga regjimet e ndryshme totalitare si nazizmi në Gjermani, fashizmi në Itali dhe stalinizmi në Rusi.

Disa analistë si Bruce Hoffman theksonin se “përdorime të tilla janë quajtur përgjithësisht “terror” me qëllim për të dalluar atë dukuri nga “terrorizmi”, i cili kuptohej të ishte dhuna e kryer nga njësi jo shtetërore. Megjithatë jo të gjithë bien dakord se terrorizmi duhet të konsiderohet si një ndërveprim joqeveritar.



Midis 1960-ës dhe 1970-ës, numri i atyre grupeve që mund të përshkruheshin si terroriste përfshinte jo vetëm nacionalistët, por ata të motivuar nga konsiderata etnike dhe ideologjike. Kështu u krijuan grupe të tilla si Organizata Palestineze, Basque ETA, Ushtria Provizore e Republikës Irlandeze, Brigadat e Kuqe Italiane etj. Çfarëdo kërcënimi global që mund të bëjë al Kaeda, pikëpamja amerikane mbi terrorizmin mbetet në një nivel gjerësisht egocentrik, pavarësisht nga administrimi aktual i të ashtuquajturës “lufta globale kundër terrorizmit”.

Siç përcaktohet nga analistët, terrorizmi shkon përtej al Kaedës, i cili jo vetëm paralajmëron, por, gjithashtu, do të mbijetojë. Me fjalë të tjera, nëse terrorizmi do të merret në konsideratë efektivisht, ndonjë kuptim i tij mund të shkojë përtej

kërcënimeve aktuale të bëra nga organizata të veçanta. Pa llogaritur mirë kufijtë e çështjes, jo vetëm që terrorizmi nuk do të zgjidhet, por ai, gjithashtu, rrezikon të bëhet i pamenaxhueshëm.

Duke parë kërcënimin në rritje të popullsisë civile ndaj akteve terroriste, reagimi ligjor ndaj këtyre veprimeve duhet të jetë më i ashpër, me masa më të forta shtrënguese, jo vetëm ligjore por, njëkohësisht edhe institucionale, me synim parandalimin dhe luftimin e veprimeve terroriste. Por le të shohim, së bashku, cili është reagimi ligjor që juristët kanë bërë ndaj kësaj dukurie.

Ekzistojnë dy reagime ligjore brenda të cilave mund të luftohet terrorizmi. Ligji penal i brendshëm dhe ligji ndërkombëtar. Fillimisht le të shohim reagimin ligjor ndaj veprimtarisë terroriste sipas legjislacionit ndërkombëtar



TERRORIZMI

SIPAS LEGJISLACIONIT NDËRKOMBËTAR

1. Përkufizimi sipas akteve ndërkombëtare.

Gjithë bota sot përballet me dilemën çfarë është terrorizmi? Kush është terrorist? etj. Lidhur me terrorizmin janë bërë përpjekje të shumta për ta përkufizuar por pavarësisht nga to ende sot, nuk ka një përkufizim të pranuar nga bashkësia ndërkombëtare. Ekzistenca e një përkufizimi pune në lidhje me terrorizmin do të ndihmonte për studimin e çështjes së reagimit ligjor ndaj dukurisë së terrorizmit. Filozofë të ndryshëm dhe juristë janë përpjekur ta përkufizojnë "terrorizmin" duke dhënë përcaktime të ndryshme. Kështu, "Terrorizmi për një njeri është luftëtar i lirisë, për një tjetër është kriminel"- thotë Klishe. Disa përkufizime fokusohen në mënyrën e veprimit të një organizate, ndërsa të tjerët në motivimet dhe karakteristikat e akteve dhe pjesëmarrësve individual.

Përpjekja e parë ndërkombëtare, për të pranuar një përkufizim, u bë nën drejtimin e Lidhjes së Kombeve në një projekt të Konventës për Ndalimin dhe Dënimin e Terrorizmit, më 1973, por Konventa nuk hyri asnjëherë në fuqi. Përkufizimi ishte: "Të gjitha aktet kriminale të drejtuara kundër një shteti me synimin për të krijuar një gjendje terrori në mendjen e personave, të grupeve të veçanta ose të publikut të gjerë".

Vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara, me gjithë përpjekjet e shumta, duke negociuar rezoluta të OKB-së dhe konventa shumëpalëshe që trajtojnë aspekte të ndryshme të operacioneve terroriste, nuk

kanë arritur në një konsensus për përkufizimin e termit të terrorizmit. Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme nr. 51/210 (1996): "Dënon fuqimisht të gjitha aktet, metodat dhe praktikatat e terrorizmit si kriminale dhe të pajustificueshme, të kryera kudo dhe nga kushdo", gjithashtu "Thekson se aktet kriminale të drejtuara kundër një shteti me synimin për të krijuar një gjendje terrori në mendjen e personave ose grupeve të veçanta ose të publikut të gjerë që janë në çdo rrethanë të pajustificueshme, pavarësisht nga konsideratat politike, filozofike, ideologjike, racore, etnike, fetare ose të çdo natyre tjetër, që mund të përdoren për t'i justifikuar ato".

Konventa për Ndalimin e Financimeve të Terrorizmit (1999) përcakton si shkelje çdo akt të sigurimit ose mbledhjes së fondeve me synimin ose dijeninë se këto fonde do të përdoren, tërësisht ose pjesërisht, për kryerjen e shkeljeve të paraqitura në konventat e tjera ndërkombëtare për terrorizmin, si për rrëmbimin e avionëve, të bombardimeve dhe veprimeve të tjera të lidhura me qëndrime terroriste. Gjithashtu, përcakton si shkelje "çdo akt tjetër që synon të shkaktojë vdekjen ose dëmtime të rënda të civilëve ose të çdo personi tjetër që nuk merr pjesë aktive në veprime luftarake, në situatë të konfliktit të armatosur, kur qëllimi i këtyre akteve, nga natyra ose konteksti i tyre, është të frikësojë një popullsi ose të detyrojë një qeveri ose organizatë ndërkombëtare të kryejë ose abstenojë në kryerjen e çdo akti". Përveç përpjekjeve të organizmave

TERRORIZMI

SIPAS LEGJISLACIONIT NDËRKOMBËTAR

ndërkombëtarë, ekziston një numër i madh përkufizimesh të botës akademike, të botuara në tekste të ndryshme. Por vetëm disa prej tyre janë ato që kanë spikatur dhe janë pranuar :

- “ Terrorizmi është një metodë që ngjall ankthin e veprimeve të dhunshme të përsëritura, e përdorur nga individë, grupe, ose aktorë shtetërorë, gjysmë klandestinë, për arsye politike, ku në kontrast me vrasjet objektivat e drejtpërdrejtë të dhunës nuk janë objektivat kryesorë. Objektivat e drejtpërdrejtë njerëzorë të dhunës, në përgjithësi zgjidhen rastësisht ose me selektim nga popullsia që është në objektivat dhe shërbejnë si mesazh. Përdoren procese komunikimi, të bazuara në kërcënim dhe dhunë, midis terroristëve, viktimave dhe objektiveve kryesorë, për të manipuluar objektivat kryesor, duke e kthyer atë në një objektivat terrori, objektivat kërkesash ose në një objektivat për tërheqje vëmendjeje, në varësi të faktit se kërkohet frikësim, kërcënim ose propagandë ”.

- “ Terrorizmi është një akt që kryhet për të arritur një objektivat johuman ose korruptiv dhe që përfshin kërcënimin e sigurisë, dhe në shkelje të të drejtave të njohura nga feja dhe njerëzimi”.

- “ Aktet terroriste janë ekuivalentet e kohës së paqes për krimet e luftës. Meqenëse përpjekjet për të pasur një përkufizim, të pranuar nga një akt ndërkombëtar për momentin, mund të themi që kanë dështuar, le të shohim se si është parashikuar ky përkufizim sipas legjislacioneve të brendshme të disa shteteve të ndryshme.

Përkufizimi sipas legjislacioneve të vendeve të ndryshme

1. Mbretëria e Bashkuar Terrorizmi është “përdorimi i dhunës për qëllime politike dhe përfshin përdorimin e çdo lloji dhune për të frikësuar publikun ose një pjesë të tij”. Terrorizmi është përdorim ose kërcënim veprimi që: 1) përfshin dhunë serioze kundër një personi ose dëmtim serioz për shëndetin ose sigurinë e publikut ose të një sektori të publikut, ose destinohet të ndërhyjë seriozisht ose shkatërrojë një sistem elektronik; 2) ose kërcënim për të ndikuar mbi një qeveri ose për të frikësuar publikun; 3) ose kërcënim që bëhet për qëllime politike, fetare ose ideologjike.

2. Kanada Akti Kundër Terrorizmit 2001 e përkufizon “veprimtarinë terroriste” si një akt që ndërmerret për qëllime politike, fetare ose ideologjike dhe kërcënon publikun ose sigurimin kombëtar, duke vrarë dëmtuar seriozisht ose kërcënuar një person, duke shkaktuar dëmtime serioze të pasurisë që mund të dëmtojë seriozisht popullin ose të ndërhyjë për të shkatërruar një shërbim bazë, instalim ose sistem.

3. SHBA “Terrorizëm do të thotë veprimtari që përfshijnë akte dhune ose akte të rrezikshme për jetën e njeriut dhe që janë shkelje të së drejtës penale të SHBA-së ose çdo shteti; dhe duket që synon të frikësojë ose trembë popullsinë civile, të ndikojë në qëndrimin e qeverisë me shkatërtime masive, vrasje ose rrëmbime”.



4. Itali Ligji italian nuk specifikon një përkufizim të terrorizmit, megjithatë ai siguron në rastin e kryerjes së veprave të zakonshme, si rrethana renduese ose cilësuese, kur këto vepra janë ndërmarrë për qëllime terroriste ose për prishje të rendit demokratik. Njëkohësisht në Kodin Penal Italian ekzistojnë dispozita që përcaktojnë se “çdo njeri që promovon, krijon, organizon, menaxhon ose financon organizata, qëllimi i të cilave është kryerja e akteve të dhunës për qëllime terrorizmi ose për shkatërrimin e rendit demokratik, do të dënohet me burgim nga 7-15 vjet. Gjithashtu, përcakton se “çdo njeri që merr pjesë në një organizatë të tillë dënohet me burgim nga 5-10 vjet. Dënimi për terrorizëm do të zbatohet edhe kur aktet e dhunës janë drejtuar kundër një shteti të huaj, ose institucioni ose një organizate ndërkombëtare. Së fundi, Kodi Italian Penal përcakton si vepër penale edhe rekrutimin e anëtarëve të grupeve terroriste .

5. Franca Në statusin e saj për veprat penale Franca, ashtu si edhe Italia, i ka përcaktuar aktet terroriste, duke kombinuar ekzistencën e një shkelje të zakonshme të ligjit penal me një element synimi terrorist. Së pari, duhet të jetë krim që të përfshihet në Kodin Penal dhe të përfshijë: përpjekjen më dashje për të vrarë ose dëmtuar, rrëmbimin ose izolimin, rrëmbimin e një avioni, anijeje, ose mjeteve të transportit, vjedhjen, shkatërrimin me dashje, vandalizimin dhe krime të caktuara kompjuterike, prodhimin ose posedimin e mekanizmave letale ose eksplozivave, përfshi armët biologjike ose me bazë toksine, pastrimin e parave dhe fshehjen e

shkeljeve të paraqitura më lartë. Së dyti krime ose shkelje të tilla të ligjit penal duhet të lidhen me një përpjekje individuale ose kolektive për të prishur rendin publik në shkallë të rëndë me mjete frikësimi ose terrori. Disa shkelje terroriste si anëtarësimi në grupe terroriste ose financimi i terrorizmit kanë përkufizimet e tyre të veçanta në Kodin penal. Përveç rregullave të zakonshme për rrethanat renduese, Kodi Penal siguron rritjen në maksimum të dënimit për shkelje të veçanta, kur shkelja përbën akt terrorist¹⁰.

Elementet e përkufizimit

Pavarësisht nga formulimet e ndryshme që gjejmë në shtete të ndryshme në përpjekjet e tyre për të përkufizuar termin e terrorizmit, pothuajse në të gjitha përkufizimet gjejmë disa elemente të përbashkët. Përcaktimi i këtyre elementeve duhet të nxisë shtetet, në arritjen e konsensusit për një përkufizim në nivel ndërkombëtar. Në vijim po paraqesim elementet që në fakt duhet të përmbajë përkufizimi i termit të terrorizmit:

- a) Synimi - shumë përkufizime kërkojnë që pa tjetër kryerja e akteve terroriste të ngjallë terror, frikë ose kërcënim ndaj një popullsie, qeverie ose grupi të caktuar.
- b) Motivimi- pothuajse në të gjitha përkufizimet përcaktohet si element kryesor i akteve terroriste, motiv i dallueshëm politik, social, ideologjik ose fetar.
- c) Mjetet- përkufizimet e terrorizmit kërkojnë përdorimin e mjeteve për kryerjen e akteve terroriste dhe të realizimit të kërcënimit për dhunë, shkatërrime, etj.
- ç) Objektivat - aktet kriminale terroriste

TERRORIZMI

SIPAS LEGJISLACIONIT NDËRKOMBËTAR

kanë objektiva të shumëllojshëm, kështu ato mund të drejtohen ndaj një popullsie të tërë, ky objektiv kufizohet ndaj civilëve, mund të përfshijë pasurinë, infrastrukturën dhe interesa të tjerë ekonomikë e socialë.

d) Subjektet - përkufizimet tregojnë se aktet terroriste kryhen nga individë, organizata terroriste, grupe terroriste etj.

Duket se bashkësia ndërkombëtare do të dëshironte një përkufizim të terrorizmit, për ta llogaritur më mirë atë dhe për të ndërmarrë përpjekje të frytshme në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar. Por arsyet për mungesën e një përkufizimi unik në nivel ndërkombëtar janë të shumta. Kështu, shtetet duan të ruajnë sovranitetin e tyre dhe parapëlqejnë të kenë përcaktimin e tyre për terrorizmin në vendin e tyre. Ato mund të mos duan një përkufizim formal që do të kufizonte lirinë e veprimit të tyre në çdo situatë të veçantë.

Shumë shtete simpatizojnë shkaqe të veçanta politike ose frenohen nga ndjeshmëri politike brenda popullsisë së tyre.

Siç po e shohim, për termin “terrorizëm” jepen shumë përkufizime, pavarësisht se shumica e përkufizimeve kanë elemente të përbashkëta, bashkësia ndërkombëtare nuk ka arritur të përcaktojë një definicion të pranuar në mënyrë universale. Për studimin e aspekteve ligjore të antiterrorizmit, juristëve u lind e drejta të përcaktojnë një përkufizim. Ne do të rekomandonim përkufizimin e mëposhtëm: “Kërcënimi ose përdorimi i dhunës ose i akteve të tjera që rrezikojnë ose rezultojnë në dëmtime serioze ndaj jetës së personit, dëmtime të ndjeshme ndaj pasurisë ose

interesave të tjera ekonomike, ose ndërhyrje të ndjeshme ose ndërprerje të shërbimeve bazë, instalimeve, sistemeve, nga subjekte jo shtetërorë, me synimin për të frikësuar ose trembur një grup, popullsi ose qeveri të një vendi, për arritjen e objektivave politike, sociale ose fetare”.

Penalizimi i akteve terroriste

Lufta kundër terrorizmit tashmë përbën një çështje të vetëmbrojtjes; kjo e drejtë njihet nga Karta e Kombeve të Bashkuara. Duke pasur parasysh ngjarjet e fundit ndërkombëtare terroriste, në disa raste, e drejta e vetëmbrojtjes mund të marrë përparësi ndaj objektivit ligjor penal dhe mund të kërkojë përdorimin e forcave të armatosura, përveç ose në vend të masave të procedimit penal. Duke ditur që sistemi i drejtësisë penale dhe veprimi ushtarak në vetëmbrojtje i shërbejnë një objektiv, parandalimit të sulmeve të ardhshme terroriste, asgjësimi dhe shkurajimi i grupeve terroriste kërkon përdorimin e dhunës.

Ashtu siç pamë edhe më lartë, përpjekjet për penalizimin e veprimtarisë terroriste janë të shumanshme, si në planin ndërkombëtar edhe në atë të legjislacioneve të brendshme, të shteteve individuale. Detyrim themelor, por njëkohësisht edhe sfidë për mbarë bashkësinë ndërkombëtare mbetet axhustimi i politikave për të bërë efektive luftën kundër kërcënimit më të ri të njerëzimit, duke mbajtur parasysh vlerat fundamentale dhe liritë civile. Këto politika duhet të orientohen në luftën kundër



financimit të terrorizmit, mbrojtjes civile, ndjekjes ligjore ndaj terroristëve dhe sjelljes së tyre para organeve të drejtësisë. Pra, ekzistojnë dy regjime ligjore brenda të cilave mund të reagohet ndaj terrorizmit. Ligji penal i brendshëm i shteteve individuale dhe ligji ndërkombëtar. Shtetet në të gjithë botën i quajnë aktet terroriste shkelje të ligjit të tyre të brendshëm penal. Një sërë traktatesh dhe konventash ndërkombëtare trajtojnë aspekte të ndryshme të terrorizmit, duke i karakterizuar ato si akte kriminale dhe duke u bërë thirrje shteteve të miratojnë ligje që t'i lejojnë shtetit të vendosë juridiksionin penal mbi kriminelët dhe t'i gjykojë ata për aktet terroriste ose t'i ekstradojë ata në një vend që është i gatshëm t'i gjykojë. Këto konventa antiterroriste përfaqësojnë gjykimin moral, të një pjese të madhe të botës moderne, se terrorizmi është një e keqe që duhet të zhduket nga skena botërore.

Por, duhet pasur parasysh që mjetet për këtë duhet të jenë ato juridike penale të shteteve anëtare. E theksojmë këtë pasi ekzistojnë argumente që ne do t'i shtjellojmë më poshtë, për përdorimin e dhunës ndaj akteve terroriste. Pra, për të pasur një reagim ushtarak ndaj dukurisë së terrorizmit dhe elementëve të tij. Një nga konventat e cila ka për qëllim të zgjerojë përpjekjet e shteteve në parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit dhe efekteve negative të tij, për gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe në veçanti për të drejtën e jetës, e cila përcakton marrjen e masave në nivel kombëtar dhe nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar, është Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit, e hapur për nënshkrim në Varshavë, më 16.05.2005. Le të njihemi konkretisht me parashikimet e kësaj Konvente në planin krahasues me legjislacionin tonë të brendshëm.



Pyetje pa përgjigje

Deputetja Alma Lama (LDK)

Për Kryeministrin e Kosovës, z. Hashim Thaçi

- Pse gjatë këtyre viteve nuk keni bërë asnjëherë rritje të shumës që jepet si ndihmë sociale?
- Pse qeveria e Kosovës anashkalon 148 mijë banorët e saj, që jetojnë në kushte të varfërisë ekstreme?

Deputetja Alma Lama (LDK)

Për Ministrin e punëve të Brendshme z. Bajram Rexhepi

Ekziston një listë e organizatave terroriste të shpallura nga OKB-ja, dhe po kështu një tjetër listë, shumë më e zgjeruar nga BE. Shtete të ndryshme kanë gjithashtu listat e tyre për organizatat që i konsiderojnë terroriste dhe në bazë të tyre ndiqen edhe veprimet konkrete.

- A ka shteti i Kosovës një listë të tillë, nëse jo, pse?, duke pasur parasysh edhe rreziqet e mëdha që mund ti vijnë Kosovës si një shtet i pakonsoliduar edhe në aspektin e sigurisë?

Deputeti Xhafer Tahiri

Për Kryeministrin e Kosovës z. Hashim Thaçi

Varfëria është një nga çështjet sociale më akute sot në Republikën e Kosovës. Në këto katër vite varfëria në Kosovë ka ardhur gjithnjë duke u rritur sidomos varfëria e skajshme. Familje të tëra jetojnë në varfëri, ku shumë prej tyre jetojnë në varfëri të skajshme, shumë familje të tjerave u kërcënohet varfëria si pasojë e pasigurisë sociale dhe mungesës së zhvillimit ekonomik. Raportet kredibile ndërkombëtare tregojnë varfërinë në shkallë shumë të lartë. Shumë familje të tjera do të binin këtë kategori sikur të mos ishte solidariteti i diasporës sonë të cilët mbështesin familjet e tyre në Kosovë. Nga varfëria më të goditurat janë dy kategori, të rinjtë dhe gratë.

- Cilat janë programet, politikat dhe programet e qeverisë tuaj për vitin 2014 që kanë për qëllim në mënyrë specifike zvogëlimin e varfërisë në Kosovë dhe cili pritet të jetë efekti i këtyre masave, për sa do të zvogëlohet varfëria e familjeve kosovare gjatë vitit 2014. Po ashtu cilat projekte të qeverisë në mënyrë specifike do të targëtojnë ndihmë konkrete për dalje nga varfëria për gratë dhe të rinjtë?

Deputetja Ganimete Musliu (PDK)

Për Ministrin e Drejtësisë z. Hajredin Kuçi

Javën që lamë pas nga EULEX-I u morën në pyetje edhe Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës mbi dyshimet e bazuara plotësisht në shpifje dhe thashetheme të dëshmitarëve që tashmë po dihen publikisht të shantazhuar.

- Ju si Ministri e Drejtësisë kur do ta thoni fjalën tuaj në këtë drejtim?

Deputeti Daut Haradinaj, (AAK)

Për Ministrin e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës, z. Agim Çeku

Z. Ministër si Kryetar i Komisionit për verifikimin e Dëshmorëve të Kombit, Invalidëve dhe Veteranëve të Luftës, statusin e Veteranit a do ta marrin anëtarët e infiltruar të UDB-së në UÇK?

Deputetja Albulena Haxhiu (VV)

Për Ministrin e Drejtësisë z. Hajredin Kuçi

Në numrin 8 të gazetës mujore Preportr dhe në disa media të shkruara përflitet se në kohën sa Zejnel Kelmendi ishte rektor i Universitetit të Prishtinës, juve dhe disa ligjëruesve të tjerë ju janë ndarë sipërfaqe të paluajtshmërisë në pjesën e qytetit të Prishtinës që quhet lagja e Universitetit. Për më tepër theksohet se këto paluajtshmëri janë regjistruar në librat kadastral të Komunës së Prishtinës pranë Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër me një vendim të datës 9 Korrik 2003. Ekziston dyshimi se këto paluajtshmëri janë regjistruar në mënyrë të kundërligjshme në librat publik.

1- Cila është e vërteta në lidhje me këtë pasuri të paluajtshme?

2- Pas deklaratave të bëra nga Serbia se do ti organizojë zgjedhjet edhe në territorin e Republikës tonë, cilat janë masat që i keni marrë ju si Qeveri, ose do ti ndërmerrni, për parandalimin e këtyre zgjedhjeve?

Deputeti Agim Kuleta (L për B)

1- Për Ministrin e Drejtësisë z. Hajredin Kuçi

Në vitin 2000, nga pjesa veriore e Mitrovicës janë dëbuar me dhunë rreth 12000 shqiptarë. Që nga ajo kohë ata vazhdojnë të mos mund të kthehen në pronat e tyre . Për kundër faktit që e drejta në pronë, e drejta për qarkullim të lirë dhe shumë të drejta të tjera, që sot përbëjnë standart elementar ndërkombëtar, e që janë shkelur në këtë rast do të duhej të nxitnit faktorin ndërkombëtar, si promovues i këtyre të drejtave, e sidomos qeverinë e vendit tonë. Lidhur me këtë çështje ,jo vetëm që nuk është bërë asgjë, por madje është heshtur tërësisht. Në anën tjetër, në format më të ndryshme, jeni angazhuar në kthimin e qytetarëve të tjerë jo shqiptarë në pronat e tyre. Pra kemi të bëjmë me një trajtim selektiv e diskriminues ndaj shqiptarëve.

- Çfarë do të na thoni ne si deputetë, z. zv/kryeministër, e sidomos qytetarëve të dëbuar me dhunë për këtë injorim të vazhdueshëm që ua keni bërë atyre?

2- Për Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, z. Dardan Gashi

MMPH, më datën 9 Shtator 2013, nxori një vendim i cili kërkon mbylljen dhe ndalimin e përkohshëm të të gjitha aktiviteteve në Monumentin e Natyrës me rëndësi të veçantë “ Shpella e Gadimes ”. Konsideroj që ky ishte një vendim i drejtë, kur kemi parasysh degradimin e vazhdueshëm për shkak të menaxhimit që ka përjetuar ky monument. Mirëpo, në të njëjtin vendi ishte paraparë që në të njëjtin afat të arsyeshëm kohor. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, të ndërmarrë masat e nevojshme për themelimin e Drejtorisë për Administrimin e Monumentit të Natyrës me rëndësi të veçantë “Shpella e Gadimës”.

Z. Ministër , pse institucionet e obliguara për zbatimin e këtij vendimi edhe pas 5 muajsh nga nxjerrja e tij, nuk e themelojnë këtë drejtori?

Deputetja Donika Kadaj - Bujupi (AAK)

Për Ministrin e punëve të Brendshme z. Bajram Rexhepi

Z. Ministër, Kosova është në fazën e përfundimit të reformës zgjedhore ndërkohë problem kyç mbeten listat e pa pastruara.

- A keni filluar pastrimin e listave dhe deri ku ka mbërritur ky proces?

Deputetja Albana Gashi (VV)

Për Ministrin e punëve të Brendshme z. Bajram Rexhepi

Gjatë protestave që po organizohen nga studentët e Universitetit të Prishtinës, kundër abuzimeve e korrupsionit në këtë institucion , kemi parë një numër të madh të forcave të rendit të cilët përveçse janë futur në hapësirat e Universitetit, kanë përdorur dhunë kundër studentëve protestues.

- Mbi çfarë baze ligjore është urdhëruar Policia e Kosovës që të futet në ambientet e Universitetit?

Deputeti Halit Krasniqi (PDK)

1- Për Ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Agim Çeku

Shqetësimet e Veteranëve, të Invalidëve, pjesëtarëve dhe të internuarve të UÇK-së, janë mjaft brengosësh për zgjidhjen e statusit të tyre. Trajtimi që aktualisht kanë ata është i padenjë për shoqërinë tonë dhe për institucionet e Republikës së Kosovës. Duke parë gjendjen e kësaj pjese të shoqërisë sonë, e cila është kontribuuesja për krijimin e këtij realiteti, më imponohet kjo pyetje.

- I nderuar Ministër! E gjithë kjo shtresë e shoqërisë sonë dhe opinionin e gjerë e kanë mirëpritur emërimin tuaj në cilësinë e kryetarit të komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e Statusit të Veteranëve , Invalidëve, pjesëtarëve dhe të internuarve të UÇK-së. Tani aktualisht ka vërejtje për arzhunim në punën e Komisionit.

Është me interes për opinionin e gjerë dhe për Kuvendin e Kosovës ta njoftoni për sfidat që ka Komisioni dhe afatin kohor se kur do ta përfundoni procesin e verifikimit?

2- Për Ministrin e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës z. Fadil Ismajli

Pakënaqësitë e qytetarëve për amnistimin e shpenzimeve të energjisë elektrike, janë të shpeshta dhe të shumta në numër. Nuk do të duhej të dyshoj në arsyeshmërinë e tyre. Shumë nga ekspertët e njehsorëve elektrikë shprehin dyshime në cilësinë e tyre.

- I nderuar Ministër! Duke qenë se ju jeni emëruar para pak kohësh në cilësi të ministrit në këtë ministri, shumë nga pakënaqësitë, nuk ju adresohen juve personalisht, por tani për ndryshimin e gjendjes jeni përgjegjës.

- Cilat kanë qenë angazhimet tuaja për vlerësimin e shqetësimeve të konsumatorëve të energjisë elektrike?

- A keni plane për ta ndryshua gjendjen?

Deputeti Salih Morina, (LDK)

Për Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, z. Besim Beqaj

Taksa ekologjike në vlerë prej 10 euro, është shuma e cila paguhet nga qytetarët e Kosovës për regjistrimin e automjeteve, mjete të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e ambientit. Më intereson ta di se sa është totali i mjeteve buxhetore vjetore që grumbullohet nga kjo taksë ekologjike dhe këto mjete buxhetore a shpenzohen vërtet për mbrojtjen e ambientit, apo cili është destinimi i këtyre mjeteve?

Deputeti Muhamet Mustafa

Për Ministrin e Drejtësisë z. Hajredin Kuçi

Në shtator të vitit 2011 në kuadër të çështjeve jashtë rendit të ditës kam ngritur çështjen e helmimit të nxënësve të shkollave të mesme në Kosovë në pranverë të vitit 1990, e cila pat marrë përmasa masive dhe është përcjell me pasoja të rënda shëndetësore për mijëra nxënës në shumë komuna të Kosovës. Shumë ekspertë dhe humanistë duke përfshirë edhe ata ndërkombëtar kanë ngrehur dyshime të bazuara se këto ishin helmime të qëllimta të organizuara nga qarqe të fushatës së atëhershme që bënte regjimi serb kundër Kosovës. Me këtë rast i kam dorëzuar Ministrin të Drejtësisë edhe një publikim të autorit suedez, i cili flet për urgjencën e hetimeve, pasi shumë dëshmitarë të vlefshëm mund të humbin.

- E lus Ministrin e Drejtësisë të na informojë se çfarë është bërë në ministri edhe në kuadër të Institutit për Krime Luftë dhe cila është qasja për ta ndriçuar helmimin e të rinjve të Kosovës në pranverë të vitit 1990?

Deputetja Kimete Bytyçi (LDK)

Për Ministrin e punëve të Brendshme z. Bajram Rexhepi

Policia e Kosovës si segmenti kryesor për rruajtjen e rendit dhe sigurisë së qytetarëve të vendit, janë duke u përballur me kushte jo të favorshme për kryerjen e detyrave të punës, si; uniformat nuk i kanë të kualitetit të mirë , pagesat për ndërrimin e natës është shumë e ulët etj. .

- Andaj kërkoj nga ana juaj z. Ministër që të më njoftoni se a janë marrë masa për përmirësimin e kushteve për Policinë e Kosovës !?
Ju faleminderit për mirëkuptim dhe bashkëpunim.

Deputetja Zhevahire Izmaku

Për Ministrin e punëve të Brendshme z. Bajram Rexhepi

Fenomeni i lypsisë është në të gjithë botën, por në vendin tonë vitet e fundit ka marrë përmasa të larta me të cilën ndeshemi në rrugë në ambiente të mbyllura, kafene, ambulanca, objekte fetare etj. Neve si qytetarë, këta lypsarë , na ofrohen herë si viktime herë të shtrirë në rrugë, njerëz me aftësi të kufizuara, pleq e plaka, gra kryesisht që njihen si romë por jo kosovare me fëmijë në dorë, për të cilat ka të dhëna se janë edhe të droguar, por kemi edhe raste , që këta lypsarë vijnë edhe në formën tjetër, atë të përfaqësuesve të organizatave humanitare derë më derë në shtëpitë tona me disa dokumente të rejshme në dorë. Duke sjellë një imazh shumë të vrazhdë në këto veprime , del përshtypja sikur asnjë organ shtetëror nuk po i sheh këto veprime.

- A keni një plan veprimi, pas strategjisë e cila doli e paefektshme, për të punuar sado pak në këtë drejtim, për ndaljen e këtij fenomeni që po jep një përshtypje të gabuar vendit tonë?
- A keni një strategji apo një bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për ta trajtuar në disa drejtime këtë fenomen, duke ditur se Kosova në raporte të ndryshme është referuar edhe si vend transiti për trafikim njerëzor, etj. ?

SPORT, ART, KULTURË



EKIPI PËRFAQËSUES I KOSOVËS



Fadil Vokrri,
kryetar i FFK-së:

“...Mendoj se dërguam një mesazh të mirë se dimë të organizojmë ndeshje dhe se padrejtësisht kemi qenë në izolim”.

KAMPIONE E BOTËS MAJLINDA KELMENDI



Shtatë boksierë përfaqësojnë Kosovën në
'Mimosa e Artë'



BUKUROSHJA KOSOVARE, SIDRITA SADIKAJ

Përfaqësoi denjësisht Kosovën në Kinë " Miss Bikini Universe". Ajo u zgjodh në mesin e pesë femrave më të bukura në botë. Kina është një vend që nuk e ka njohur Pavarësinë e Kosovës, Sidrita ka kontribuar për njohjen e Kosovës si shtet duke u paraqitur me flamurin shtetëror. Veshja kombëtare e Kosovës u përzgjodh në mesin e tri veshjeve më të mira në botë



SHUHET DIVA E MUZIKËS SHQIPTARE VAÇE ZELA



Amaneti

Kur të vdes
Dua të kaloj
nëpër Kosovë



**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

